



Misioni i Ekspertëve të Zgjedhjeve
të Bashkimit Evropian

Kosovë 2021

Raporti Përfundimtar



Zgjedhjet e parakohshme legislative

14 shkurt 2021

Misionet e Ekspertëve të Zgjedhjeve janë të pavarura nga institucionet e Bashkimit Evropian. Pikëpamjet dhe mendimet të shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën dhe pozicionin zyrtar të Bashkimi Evropian.



Raporti përfundimtar

I. PËRMBLEDHJE

Zgjedhjet u mbajtën për 120 deputetët e Kuvendit njëdhomësh në Kosovë. Ashtu si në katër zgjedhjet e mëparshme parlamentare që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, këto ishin zgjedhje të parakohshme të provokuara nga një krizë politike.

Zgjedhjet ishin konkurruese dhe liritë e fushatës përgjithësisht respektoheshin. Kishte fushatë dinamike me përjashtim të trevave serbe në Kosovë. Përkundër një afati shumë të shkurtër kohor dhe sfidave të shkaktuara nga pandemia COVID-19, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) administroi zgjedhjet mirë dhe në mënyrë transparente, megjithëse problemet me votimin jashtë Kosovës zvogëluan besimin në atë pjesë të procesit. Dita e zgjedhjeve u vlerësua nga vëzhguesit vendorë si e rregullt, dhe kishte pjesëmarrje të lartë të votuesve. Megjithatë, ashtu si në zgjedhjet e mëparshme, procesi u përkeqësua gjatë numërimit të votave dhe u urdhërua të bëhej rinumërimi i një numri të madh të votave për shkak të mospërputhjeve në protokollin e rezultateve. Probleme të tilla sistematike për një kohë të gjatë, të cilat janë identifikuar nga Misioni i mëparshëm i Vëzhgimit të Zgjedhjeve nga BE (MVZ BE), duhet të adresohen për t'i dhënë mundësi Kosovës të përmbushë plotësisht standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

Këto zgjedhje u mbajtën në një atmosferë gjithnjë e më të polarizuar, të ndikuara nga zhvillimet e trazuar politike që nga zgjedhjet e fundit parlamentare. Partitë kryesore shqiptare të Kosovës, përfshirë Lëvizjen Vetëvendosje (LVV), fituese e zgjedhjeve të vitit 2019 dhe favorite në sondazhet e opinionit publik në prag të zgjedhjeve, deklaruan se ato nuk do të formonin aleanca parazgjedhore me partitë e tjera parlamentare shqiptare në Kosovë, ndërsa disa figura të profilit të lartë politik e ndërruan besnikërinë partiake.

Kandidatët filluan aktivitete të ngjashme me fushatën shumë kohë përpara fillimit të fushatës zyrtare më 3 shkurt dhe në disa raste kishte grumbullim relativisht të konsiderueshme të mbështetësve, dhe shkelnin rregullat e sigurisë publike në lidhje me masat në fuqi për COVID-19. Në përgjithësi, kandidatët ishin në gjendje të bënin fushatë të lirë. Partitë politike i përqendruan mesazhet e tyre në çështjet ekonomike dhe sociale si dhe në masat anti-korrupsion dhe sundim të ligjit. Fushata në dhjetë trevat me shumicë serbe në Kosovë ishte më e zbehtë dhe aktivitetet e fushatës së partive opozitare të partisë dominuese serbe në Kosovë, Srpska Lista (SL), ishin pak të dukshme. Përfaqësuesit e këtyre partive pretenduan se kandidatët dhe mbështetësit e tyre ishin të frikësuar për shkak të presionit dhe frikësimit të përjetuar gjatë zgjedhjeve të mëparshme. Fushata në komunitetet e tjera jo-shumicë u përqendrua në çështjet lokale, duke përfshirë përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe zhvillimin ekonomik.

Korniza ligjore për zgjedhjet mbetet në thelb e pandryshuar që nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2014, përkundër rekomandimeve të misioneve të shumta të vëzhgimit të Zgjedhjeve nga BE-ja. Ekzistojnë mangësi të konsiderueshme, të tilla si zbrazësitë, paqartësitë dhe mospërputhjet që mundësojnë zbatimin jokonsistent dhe selektiv si dhe anashkalimet, duke

** Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me RKSKB 1244/1999 dhe mendimin e GJND për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.*

përfshirë KQZ-në dhe gjykatat. Kjo ndikon në mënyrë të panevojshme në aspekte të rëndësishme të procesit zgjedhor, të tilla si certifikimi i kandidatëve, regjistrimi i votuesve dhe rezultatet e zgjedhjeve.

Pothuajse të gjitha rekomandimet e mëparshme të BE-së mbeten të pa adresuara, duke përfshirë krijimin e dispozitave të qarta për kundërshtimin e rezultateve të zgjedhjeve në të gjitha nivelet, zgjatjen e afatit kohor të procesit në rastin e zgjedhjeve të parakohshme, përshkrimin e raportimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të kandidatëve si para ditës së zgjedhjeve ashtu edhe brenda 30 ditëve pas ditës së zgjedhjeve, dhe rregullimin e mëtejshëm të blerjes së kohës së transmetimit nga kandidatët për të siguruar kushte jo-diskriminuese.

Të 28 subjektet politike që kanë aplikuar janë certifikuar. Megjithatë, gjithsej 47 kandidatë të gjashtë subjekteve politike, përfshirë bartësin e listës LVV Albin Kurti, nuk u certifikuan për shkak të dënimeve penale gjatë tre viteve të fundit, në përputhje me një vendim të detyrueshëm të Gjykatës Kushtetuese. Nga 47 kandidatët që nuk u certifikuan, tre prej tyre në fund u certifikuan, pas një vendimi të Gjykatës Supreme, 20 u zëvendësuan nga subjektet e tyre politike ndërsa 24 u fshinë nga listat pa u zëvendësuar. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) skualifikon individët nga e drejta për t'u kandiduar, pas një dënimi të formës së prerë për ndonjë vepër penale gjatë tre viteve të fundit, e cila është jo-proporcionale dhe në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.

Pavarësisht nga afati shumë i shkurtër për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, përgatitjet zgjedhore të KQZ-së përfunduan me kohë dhe zgjedhjet ishin të përgatitura mirë teknikisht. Procesi zgjedhor para ditës së zgjedhjeve ishte administruar mirë dhe ishte transparent me përjashtim të dukshëm të regjistrimit dhe votimit jashtë Kosovës. Atmosfera politike më e polarizuar kishte një ndikim në vendimmarrjen e KQZ-së pasi Komisioni formohet nga përfaqësues të partive politike dhe nganjëherë duhej të zbatohet votimi me shumicë të thjeshtë pasi nuk ishte gjithmonë e mundur të merreshin vendime me konsensus. Kishte mosmarrëveshje të rëndësishme brenda KQZ-së midis përfaqësuesve të LVV dhe partive të tjera. Përveç kësaj, ushtruesja e detyrës së Presidentes Vjosa Osmani, e cila ishte në krye të listës së LVV, gjithashtu kritikoi publikisht kryetaren e KQZ-së para ditës së zgjedhjeve, duke e akuzuar atë për anshmëri dhe sjellje joprofesionale.

Më 2 shkurt KQZ certifikoi listën përfundimtare të votuesve (LPV) me 1,794,862 votues. KQZ-ja mori disa vendime për të rritur saktësinë e LPV-së, duke përfshirë pastrimin e listës nga personat që kanë vetëm dokumente të UNMIK-ut, si dhe fshirjen e emrave të 11,000 personave të vdekur. Sidoqoftë, LPV ende përmban një numër të madh të personave të vdekur, dhe numri i madh i njerëzve në listë me banim të përhershëm jashtë vendit (të cilët kanë të drejtë ligjore për t'u përfshirë) e lë procesin e votimit të cënueshëm ndaj abuzimit të mundshëm për shkak të mangësive në mënyrën se si administrohet kjo pjesë e procesit.

Periudha e regjistrimit dhe votimit jashtë Kosovës u ndikua negativisht nga afati i shkurtër kohor dhe në të njëjtën kohë kishte afërsisht tre herë më shumë aplikantë në krahasim me zgjedhjet e mëparshme. KQZ-ja nuk ishte në gjendje të shqyrtojë të gjitha 130,168 aplikacionet në kohën e duhur, kryesisht për shkak të krijimit të procesit të ri të verifikimit të aplikantëve përmes thirrjeve telefonike. Prandaj, ndryshe nga lista e rregullt e votuesve, lista e votuesve jashtë Kosovës nuk

ishte në dispozicion për kontroll publik gjatë periudhës së konfirmimit dhe kundërshtimit më 25-27 janar. Lista përfundimtare e votuesve jashtë Kosovës, e cila përmbante 102,100 votues, u përpilua dhe u certifikua nga KQZ më 2 shkurt. Aplikantët e refuzuar kishin vetëm një ditë për të parashtruar ankesë ndaj rezultateve të procesit të regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, i cili kufizoi të drejtën e tyre për mjete juridike efektive.

Në përgjithësi, rreth 56,600 vota postare u përfshinë në rezultate, që përfaqësojnë më shumë se gjathtë përqind të të gjitha votave. KQZ pranoi vetëm zarfet postarë që mbërritën në Kosovë brenda afatit më 12 shkurt; rreth 9,000 paketa postare mbërritën në KQZ pas përfundimit të afatit. Arsyeja kryesore e dhënë për refuzimin e votave jashtë Kosovës ishte fakti që votuesit e mundshëm nuk ishin regjistruar me sukses, ndërsa votimi në grup ishte gjithashtu një problem i madh. Nga 79,201 vota të dërguara nga jashtë Kosovës, 56,600 u miratuan dhe u numëruan. Procesi i verifikimit të votave jashtë Kosovës ishte më i vështirë për t'u vëzhguar dhe procesi u kritikua nga përfaqësuesit e LVV si i parregullt dhe jo transparent.

Korniza rregullative për financimin e fushatës përmban kufizime për donacione dhe shpenzime, raportim, shpalosje, mbikëqyrje dhe sanksione. Ligji parasheh raportimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës për një periudhë prej 90 ditësh para ditës së zgjedhjeve. Sidoqoftë, në përputhje me praktikën e kaluar, KQZ e kufizoi kërkesën për raportim vetëm në të ardhurat dhe shpenzimet e bëra gjatë 10 ditëve të fushatës zyrtare, gjë që zvogëloi ndjeshëm transparencën dhe llogaridhënien.

Mediat dinamike në Kosovë u ofruan kandidatëve mundësi të shumta për të paraqitur mesazhet e tyre të fushatës dhe u siguruan votuesve qasje në pikëpamje të ndryshme politike. Derisa transmetuesi publik respektoi detyrimet e tij ligjore dhe u dha kandidatëve një hapësirë të drejtë dhe të paanshme në transmetimet e tij, ai dështoi të ishte i paanshëm në postimet e tij online. Në një zhvillim pozitiv, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), organi rregullator i mediave transmetuese, adresoi në mënyrë aktive shkeljet e mediave gjatë periudhës së shkurtër të fushatës, të cilat kishin të bënin kryesisht me mungesën e respektimit të rregullave nga mediat për kohën e transmetimit me pagesë / sponsorizime, dhe kjo gjendje ekziston që një kohë të gjatë në fushatat elektorale në Kosovë.

Interneti është platforma kryesore për kosovarët për t'u qasur në informacion dhe rreth 60 përqind e popullsisë i përdorin mediat sociale, kryesisht Facebook-un. Shumë kandidatë përdorën reklama me pagesë në platformat sociale, por kostot e tyre ishin të panjohura për shkak të mungesës së transparencës dhe të rregullave. LVV ishte në gjendje të përfitonte nga prania e saj e fortë në internet dhe nga aftësitë e zhvilluara mirë për të joshur votuesit përmes mediave sociale. Në disa raste, tregime qartazi lajthitëse të lidhura me zgjedhjet u botuan në mediat online, dhe të dhënat personale dhe privatësia e qytetarëve nuk ishin të mbrojtura sa duhet në disa faza të procesit.

Dita e zgjedhjeve u vëzhgua nga një numër i madh i vëzhguesve të partive politike (rreth 29,600) dhe vëzhguesve të shoqërisë civile. Përveç kësaj, një numër i madh i vëzhguesve diplomatik nga BE-ja, ambasadat e SH.B.A.-së dhe Mbretërisë së Bashkuar vëzhguan procesin e ditës së zgjedhjeve, duke kontribuar në vëzhgimin e zgjedhjeve. Votimi u mbajt në 2,382 vendvotime të vendosura në 888 qendra të votimit në të gjithë Kosovën. Bazuar në raportet nga grupet e

vëzhguesve vendas dhe nga mediat, votimi ishte i rregullt dhe i qetë. Problemet kryesore procedurale të raportuara ishin të ngjashme me zgjedhjet e mëparshme, të tilla si numri i madh i votuesve të ndihmuar, raste të shumta të votimit familjar dhe votimit me dokumente të pavlefshme, përfshirë letërnjoftimet e UNMIK-ut dhe letërnjoftimet e huaja.

KQZ vendosi të rinumërojë 564 vendvotime (gati 24 përqind) pasi kryen auditimin dhe kontrollimin e tyre të brendshëm të të gjitha rezultateve të vendvotimeve. Një numër kaq i madh i rinumërimeve tregon mungesën e profesionalizmit të këshillave të vendvotimeve dhe/ose përpjekjet për të kryer mashtime zgjedhore. Prosesi i rinumërimit të fletëvotimeve si dhe verifikimi dhe numërimi i fletëvotimeve me kusht dhe votave jashtë Kosovës zgjati 18 ditë pas ditës së zgjedhjeve. Rinumërimet zbuluan disa mospërputhje të mëdha në lidhje me numrin e votave preferenciale për kandidatët e pavarur; megjithatë, mospërputhjet në numrin e votave për subjektet individuale politike ishin shumë të vogla.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është organi kryesor për zgjidhjen e kontesteve. Rreth 30,000 aplikantëve të pasuksesshëm për t'u regjistruar për të votuar jashtë Kosovës iu mohua mjeti efektiv juridik; fillimisht PZAP njoftoi se nuk do të pranonte ankesat e parashtruara përmes postës elektronike, e cila ishte në kundërshtim me ligjin dhe mënyra e vetme e mundshme për shkak të kufizimeve në kohë; pasi mori mbi 1.000 ankesa me postë elektronike, PZAP hodhi poshtë rreth 750 për arsye se nuk përmbanin ankesën si shtojcë, e cila nuk është një kërkesë ligjore.

Bazuar në rezultatet përfundimtare (të pa-certifikuara), LVV fitoi zgjedhjet me 49.95 përqind të votave, që përkthehet në 58 vende nga 120 vendet në Kuvendin e Kosovës, e pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Partitë shqiptare të Kosovës morën gjithsej 86.6 përqind të votave totale. Të tri partitë serbe të Kosovës morën më pak se 5.3 përqind të votave, nga të cilat Srpska Lista (SL) i fitoi 5 përqind, duke siguruar 10 vendet e garantuara për komunitetin serb në Kosovë. Pas numërimit të rreth 56,600 votave nga jashtë Kosovës, LVV siguroi dy vende të tjera në rezultatet përfundimtare pasi 78.5 përqind e votave nga diaspora ishin në mbështetje të LVV.

Në një zhvillim që kërcënoi të prishte zgjidhjen delikate që parasheh Kushtetuta e Kosovës e cila garanton përfaqësim për komunitetet e ndryshme jo-shumicë, rezultatet që i dhanë disa vende të rezervuara dy subjekteve të reja politike të komunitetit jo-shumicë nuk u pranuan nga partitë konkurruese jo-shumicë të cilat pretenduan se mbështetja për ato subjekte ishte orkestruar nga SL përmes votuesve serbë të Kosovës. Iniciativa Rome (IR) dhe Ujedinjena Zajednica-Adriana Hodzic (UZ - AH) të krijuara së fundi morën një numër jashtëzakonisht të lartë të votave në disa komuna me shumicë serbe në Kosovë në krahasim me numrin e votave për subjektet politike rome ose boshnjake të Kosovës gjatë zgjedhjeve të kaluara parlamentare, ndërsa votat për subjektet politike serbe të Kosovës pësuan rënie. IR fillimisht fitoi një vend për komunitetin Rom të Kosovës, si dhe vendin shtesë të garantuar për partinë më të suksesshme në kuadër të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës. Pas parashtrimit të ankesës ndaj rezultateve përfundimtare, PZAP anuloi një numër votash nga trevat me shumicë serbe, gjë që rezultoi në humbjen e një ulëseje nga UZ-AH dhe humbjen e një ulëseje nga IR.

II. HYRJE

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të 21 dhjetorit 2020, ushtruesja e detyrës së presidentes shpërndau kuvendin dhe shpalli zgjedhjet e parakohshme parlamentare më 14 shkurt 2021. BE dërgoi një Mision të Ekspertëve të Zgjedhjeve (MEZ) të përbërë nga tre ekspertë të cilët mbërritën në Kosovë më 21 janar. Qëllimi i MEZ-së ishte mbledhja dhe analizimi i informacionit faktik, vlerësimi dhe raportimi për procesin zgjedhor kundrejt zotimeve, standardeve dhe praktikave të mira ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Misioni gjithashtu formuloi rekomandime për të përmirësuar proceset e ardhshme zgjedhore dhe vlerësoi gjendjen e zbatimit të rekomandimeve të bëra nga misionet e mëparshme. Para këtyre zgjedhjeve, BE dërgoi Misionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve në zgjedhjet në Kosovë në vitin 2013 (zgjedhjet komunale), 2014 (zgjedhjet parlamentare), 2017 (zgjedhjet komunale dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare) dhe 2019 (zgjedhjet e parakohshme parlamentare).

III. KONTEKSTI POLITIK

Kosova mbajti zgjedhjet e fundit parlamentare në tetor të vitit 2019; LVV i fitoi zgjedhjet me 26.27 përqind të votave dhe LDK doli e dyta me 24.55 përqind. Pas një numërimi të zgjatur të votave dhe procesit të parashtrësive si dhe negociatave të gjata për koalicion, qeveria e kryesuar nga Albin Kurti nga subjekti politik LVV mori detyrën më 3 shkurt 2020.

Megjithatë, partnerët e koalicionit u përballën me mosmarrëveshje dhe qeveria Kurti u rrëzua përmes votës së mosbesimit më 25 mars, pas më pak se dy muajsh në detyrë. Më 30 prill, presidenti i dha Avdullah Hotit mandatin me anë të dekretit për të formuar qeverinë si kryeministër. Dekreti u kundërshtua nga deputetët e LVV në Gjykatën Kushtetuese më 30 prill. Më 1 maj, Gjykata Kushtetuese pezulloi dekretin derisa të merrej një vendim përfundimtar dhe më 28 maj mori vendimin që dekreti ishte kushtetues dhe Presidenti mund t'i jepte një kandidati nga partia e dytë mandatin si Kryeministër i Kosovës.

Një qeveri e re e udhëhequr nga Kryeministri Hoti mori detyrën më 3 qershor 2020. Parlamenti votoi për qeverinë e Hotit në një koalicion të deputetëve nga LDK, SL, AAK, NISMA dhe nga pakicat jo serbe. Me vetëm 61 nga 120 vota në Kuvendin e Kosovës, kjo qeveri nuk mund të mbështetej në këtë shumicë për pjesën më të madhe të mandatit të saj.

Më 21 dhjetor, Gjykata Kushtetuese shpalli vendimin e saj pas kërkesës nga LVV, e cila kishte kontestuar votën vendimtare të deputetit Etem Arifi për qeverinë Hoti në muajin qershor. Megjithëse ishte urdhëruar të vuante dënimin me burgim për mashtrim në atë kohë, Z. Arifi kishte marrë pjesë në seancën e Kuvendit dhe kishte votuar në favor të qeverisë, duke ndihmuar në arritjen e shumicës minimale prej 61 votash. Vota e tij u shpall e pavlefshme nga Gjykata Kushtetuese, duke rezultuar në shpërndarjen e parlamentit dhe në zgjedhje të parakohshme brenda 40 ditëve nga shpallja e tyre.

Në ndërkohë, më 5 nëntor 2020, Presidenti Hashim Thaçi dha dorëheqje për t'u përballur me akuza për krime lufte para Dhomave të Specializuara. Aktakuzat përfshinin gjithashtu disa politikanë të tjerë të nivelit të lartë, duke përfshirë Kadri Veselin, udhëheqësin e PDK-së, një nga partitë kryesore opozitare. Pas dorëheqjes së Presidentit Thaçi, Kryetarja e Kuvendit Vjosa Osmani mori pozitën e ushtrueses së detyrës së Presidentes. Përkundër situatës së brishtë politike dhe polarizimit

të fortë në të gjithë spektrin politik, Ushtruesja e Detyrës së Presidentes Osmani bëri thirrje që zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme të mbahen më 14 shkurt 2021, ndërsa edhe ajo garoi në zgjedhje në listën e LVV.

Zgjedhjet u mbajtën në një atmosferë shumë të polarizuar ku partia fituese e zgjedhjeve të vitit 2019 dhe udhëheqësja në të gjitha sondazhet e opinionit publik parazgjedhor, LVV, ishte kundërshtarë e partive të tjera shqiptare të Kosovës. Ish Kryeministri dhe udhëheqësi i LVV Albin Kurti ishte në mesin një numri të kandidatëve të mundshëm që nuk kishin të drejtë të kandidonin për kuvend bazuar në vendimin e fundit të Gjykatës Kushtetuese. Pavarësisht kësaj, individët që kanë dënim penal, përfshirë Z. Kurti, nuk skualifikohen nga mbajtja e ndonjë posti publik, përfshirë pozitën e Kryeministrit dhe Ministrave.

Akterët Kryesorë Politikë

KQZ certifikoi 28 subjekte politike (parti politike, koalicione, iniciativa) për të marrë pjesë në këto zgjedhje. Numri i subjekteve të regjistruara për komunitete ishte: 7 subjekte shqiptare të Kosovës, 3 subjekte serbe të Kosovës, 5 subjekte boshnjake të Kosovës, 2 subjekte gorane të Kosovës, 3 subjekte të ashkalinjëve të Kosovës, 4 subjekte rome të Kosovës, 2 subjekte egjiptianë të Kosovës dhe 2 subjekte turke të Kosovës. Dhjetë subjekte të reja politike garuan në këto zgjedhje.

Tri partitë politike më të mëdha LVV, LDK dhe PDK garuan vetë në këto zgjedhje. Vjosa Osmani me listën e saj të kandidatëve të quajtur "Guxo" u bashkua me LVV para zgjedhjeve. Në mënyrë të ngjashme, LDK përfshiu listën e partisë AKR brenda listës së saj. Kandidatët për kryeministër të partive kryesore ishin lideri i LVV-së, Albin Kurti, kryeministri aktual dhe lideri i listës së LDK-së Avdullah Hoti, lideri i PDK-së Enver Hoxhaj dhe lideri i NISMA-s, Fatmir Limaj. Përveç kandidatit për Kryeministër, VV garoi edhe me një kandidate për Presidente, Znj. Vjosa Osmani-Sadriu. Për herë të parë, AAK kishte deklaruar se ata do të garojnë në zgjedhje me udhëheqësin Ramush Haradinaj për postin e Presidentit të Kosovës.

Komuniteti serb i Kosovës u përfaqësua në Kuvendin në largim me dhjetë anëtarë të SL. Dy partitë e tjera serbe të Kosovës që morën pjesë në këto zgjedhje ishin partitë e sapo regjistruara GI Za Slobodu Pravdu i Opstanak (GI SPO) dhe Srpski Demokratski Savez (SDS).

IV. IMPLEMENTIMI I REKOMANDIMEVE TË MËHERSHME NGA MVZ/MEZ TË BE-së

Pothuajse të gjitha rekomandimet e dhëna pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017 dhe 2019 mbeten të pa adresuara

Në maj të vitit 2019, para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2019 u krijua Komision ad-hoc parlamentar për Forcimin dhe Përmirësimin e Procesit Zgjedhor. Funksionoi për disa muaj, por nuk paraqiti ndonjë draft ligjor për plotësim-ndryshim. Pas zgjedhjeve të vitit 2019, asnjë iniciativë nuk u ndërmor sa i përket reformës zgjedhore. Nuk u implementua asnjë nga 23 rekomandimet e bëra nga MVZ i BE-së për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2019.

Si pasojë, pothuajse të gjitha rekomandimet e mëparshme mbeten të pa adresuara, duke përfshirë krijimin e dispozitave të qarta për kundërshtimin e rezultateve të zgjedhjeve në të gjitha nivelet, thirrjen e zgjedhjeve të parakohshme me një njoftim paraprak prej së paku dy muajsh, raportimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të kandidatëve gjatë periudhës së fushatës si dhe brenda 30 ditëve nga dita e zgjedhjeve, rregullimi i mëtejshëm i blerjes së kohës së transmetimit nga kandidatët për të siguruar kushte jo-diskriminuese, përmirësimin e dizajnit të fletëve të votimit, ngritjen e edukimit të votuesve dhe krijimin e pozitave jo-partiake në Këshillat e Vendvotimeve (KVV). Disa veprime ad-hoc u ndërmorën nga KQZ për të përmirësuar saktësinë e VR por kjo nuk ishte e parashikuar me ligj dhe nuk adreson rekomandimin në mënyrë të qëndrueshme.

V. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Korniza ligjore siç zbatohet aktualisht nuk siguron integritet dhe llogaridhënie në regjistrimin e votuesve dhe të kandidatëve

120 deputetët e Kuvendit zgjidhen për një mandat katër-vjeçar në një zonë elektorale të vetme në mbarë vendin në një sistem të përfaqësimit proporcional me votim preferencial ku votohen deri në pesë kandidatë. Njëqind vende u ndahen partive, koalicioneve, iniciativave të qytetarëve dhe kandidatëve të pavarur proporcionalisht me numrin e votave të vlefshme të siguruar. Subjektet politike që përfaqësojnë komunitetin shumicë në Kosovë kanë të drejtë për vende në kuvend nëse marrin të paktën pesë përqind të votave të vlefshme. Njëzet vende janë të rezervuara për komunitetet jo-shumicë, duke përfshirë dhjetë për komunitetin serb të Kosovës, tre për komunitetin boshnjak të Kosovës, dy për komunitetin turk të Kosovës dhe nga një për komunitetin goranë të Kosovës, komunitetin rom të Kosovës, komunitetin ashkali të Kosovës dhe komunitetin egjiptianë të Kosovës, si dhe një vend shtesë për komunitetin me numrin më të lartë të votave të siguruar nga njëra prej tri komuniteteve të fundit.

Kushtetuta thotë që marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe tejkalojnë ligjet e Kosovës dhe aktet e tjera të institucioneve publike.¹ Zgjedhjet parlamentare rregullohen kryesisht nga Kushtetuta e vitit 2008 dhe Ligji për Zgjedhjeve të Përgjithshme i vitit 2008 (LZP, i ndryshuar për herë të fundit më 2010) dhe plotësohen nga rregulloret e KQZ-së.² Korniza ligjore zgjedhore mbetet në thelb e pandryshuar që nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2014, me përjashtim të financimit të fushatës.

Në përgjithësi, korniza ligjore ka mangësi të rëndësishme, përfshirë zbrazësitë, paqartësitë dhe mospërputhjet që mundësojnë zbatimin jokonsistent dhe selektiv si dhe anashkalimet nga KQZ dhe gjykatat për çështje të rëndësishme si certifikimi i kandidatëve, regjistrimi i votuesve dhe

¹ Kosova nuk është vend nënshkrues i ndonjë traktati ndërkombëtar. Ndërsa Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) nuk ka juridiksion mbi Kosovën, neni 53 i Kushtetutës detyron autoritetet të interpretojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në përputhje me gjykimet e GJEDNJ-së. Meqenëse Kosova iu bashkua Komisionit të Venecias më 11 qershor 2014, është i zbatueshëm Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i vitit 2002 i Komisionit të Venecias.

² Pjesa tjetër e legjislacionit në fuqi përfshinë ligjin për Financimin e Subjekteve Politike dhe Fushatat Zgjedhore (2019), ligjin për Partitë Politike (2004), ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë (LMPDKPK), ligjin për Gjuhët, dispozitat përkatëse të Kodit Penal dhe ligjin për Procedurat Administrative, rregullat dhe procedurat në PZAP dhe KQZ.

rezultatet e zgjedhjeve. Gjegjësisht, LQP, rregulloret e KQZ-së si dhe rregullat dhe procedurat e PZAP-it përmbajnë dispozita ligjore të paqarta dhe kundërtënëse, duke përfshirë aftësinë për të qenë kandidat, certifikimin e subjekteve politike jo-shumicë, zgjidhjen e kontesteve, kundërshtimin e rezultateve të zgjedhjeve dhe urdhërimin e rinumërimeve dhe përsëritjen e zgjedhjeve.³ Veç kësaj, aspekte të rëndësishme të procesit zgjedhor, duke përfshirë regjistrimin dhe funksionimin e partive politike, numërimi dhe tabelat, rinumërimi i votave dhe pavlefshmëria e rezultateve si dhe rregullat e fushatës parashihen në rregulloret e KQZ-së e jo në ligjin parësor;⁴ kjo nuk ofron mbrojtje nga ndryshimet e shpeshta, të minutës së fundit, në kundërshtim me praktikën e mirë.⁵

Për më tepër, Kushtetuta nuk rregullon mjaftueshëm disa çështje që mund të shkaktojnë zgjedhje të parakohshme parlamentare.⁶ Gjegjësisht, pas një votimi të suksesshëm të mosbesimit ndaj qeverisë, Presidenti ka pushtet diskrecional për të shpërndarë Kuvendin, por Kushtetuta nuk parashih shprehimisht përpjekje alternative për të formuar një qeveri, nëse Presidenti vendos të mos e shpërndajë Kuvendin. Veç kësaj, pas zgjedhjeve parlamentare ose kur Kryeministri jep dorëheqjen ose bie qeveria, nga Presidenti kërkohet të nominohet një Kryeministër pas konsultimit me partinë ose koalicionin e shumicës që ka fituar shumicën e vendeve në Kuvend, e cila i është nënshtruar interpretimit jo konsistent për të përjashtuar apo përfshirë koalicionet e formuara në Kuvend pas zgjedhjeve. Për më tepër, Kushtetuta kërkon të ketë konsultime e jo marrëveshje dhe nuk cakton ndonjë afat përfundimtar për përfundimin e këtij procesi. Disa vendime të Gjykatës Kushtetuese për çështjet që dalin nga këto zbrazësi kanë ngritur shqetësime në mesin e bashkëbiseduesve të MEZ-së së BE-së rreth mundësisë që gjykata të ketë tejkaluar kompetencat e saj apo të ketë përdorur kompetenca të gjera diskrecionale për të interpretuar ligjin.⁷

VI. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Procesi zgjedhor ishte mirë i administruar dhe transparent, me përjashtim të dukshëm të votimit jashtë Kosovës

Administrata e zgjedhjeve në Kosovë përbëhen nga KQZ-ja, 38 Komisione Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe 2,382 Këshilla të Vendvotimeve (KVV). KQZ-ja përbëhet nga 11 anëtarë, përfshirë Kryetarin i cili emërohet nga Presidenti i Kosovës nga radhët e gjyqtarëve në Gjykatën Supreme dhe gjykatat e apelit. Kryetarja aktuale, Valdete Daka, u emërua në vitin 2010 dhe mandati i saj i dytë u miratua nga Presidenti Hashim Thaçi në vitin 2017. Përveç kryetarit jo-partiak, ka dy anëtarë të emëruar nga LVV, dhe nga një anëtar të emëruar nga LDK, PDK, AAK,

³ Për shembull, për certifikimin e kandidatit, nenet 122.1b dhe 26.6 të LQP, nenet 10.4 dhe 10.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP (Rregulli Nr.2/2015) dhe neni 6.8 i Rregullores së KQZ Nr. 8/2013.

⁴ Përfshirë Rregulloret e KQZ-së Nr.1/2013, Nr.6/2013, Nr.11/2013 dhe Nr.13/2013.

⁵ Pjesa II.2.a. e [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias](#) thekson: “Përveç rregullave teknike dhe atyre për hollësi - të cilat mund të nxirren si rregullore prej ekzekutivit – rregullat e së drejtës zgjedhore, duhet të nxirren të paktën në nivelin e ligjit; Shih gjithashtu paragrafët 35, 63, 65 dhe 67.

⁶ Veç kësaj, nuk ka *Travaux Preparatoires* të Kushtetutës të cilat mund të sqarojnë disa çështje.

⁷ Vendimet e Gjykatës Kushtetuese për [Kompetencat e Presidentit \(01.07.2014\)](#), [nominimi i Hotit si Kryeministër \(01.06.2020\)](#), [votëbesimi i qeverisë së Kryeministrit Hoti – pamundësia e kandidimit të deputetit Arifi \(21.12.2020\)](#)

Nisma, SL, VAKAT (komuniteti Boshnjak i Kosovës), KDTP (komuniteti Turk i Kosovës) dhe nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian të Kosovës.

Ndryshe nga zgjedhjet e mëparshme, KQZ-së iu desh të merrte disa vendime të rëndësishme duke përdorur një shumicë të thjeshtë votash e jo me konsensusin e zakonshëm pasi kishte mosmarrëveshje të konsiderueshme midis përfaqësuesve të partisë kryesore LVV dhe partive të tjera shumicë shqiptare të Kosovës. Të dy përfaqësuesit e LVV në KQZ kritikuan Kryetaren e KQZ-së për kundërshtimin e propozimeve të LVV-së në lidhje me votimin jashtë Kosovës dhe certifikimin e kandidatëve. Vlen të përmendet se Ushtruesja e Detyrës së Presidentes, Vjosa Osmani e cila ishte në krye të listës LVV për Kuvendin e Kosovës, bëri deklarata publike duke akuzuar Kryetaren e KQZ-së për anshmëri dhe sjellje joprofesionale në udhëheqjen e KQZ-së.

Në përgjithësi, KQZ-ja punoi në mënyrë transparente. Takimet ku merreshin vendimet ishin të hapura për publikun dhe vendimet u botuan në përgjithësi në faqen e internetit të KQZ-së, megjithëse disa vendime azhurnoheshin herë pas here më vonë. Përkundër kornizës kohore shumë të shkurtër prej 39 ditësh, dhe sfidave të paraqitura nga pandemia COVID-19, përgatitjet për zgjedhje përfunduan në kohë dhe zgjedhjet ishin përgatitur teknikisht mirë. Procesi zgjedhor para ditës së zgjedhjeve ishte administruar mirë dhe ishte transparent, me përjashtim të dukshëm të regjistrimit dhe votimit nga votuesit jashtë Kosovës.

Përpara zgjedhjeve, KQZ përgatiti një raport bazuar në provat e mbledhura gjatë rinumërimit të rreth 80 përqind të vendvotimeve në vitin 2019 dhe identifikoi 346 vendvotime ku sjellja e stafit të vendvotimeve ishte raportuar në zyrën e prokurorit. Kjo i atribuohet deri diku mungesës së trajnimit të duhur sidomos për Kryesuesit e Vendvotimeve (VV), si dhe vendimeve të qëllimshme të gabuara nga stafi i VV-ve. Megjithatë, nuk u mor asnjë masë e re ose veprimtari shtesë për trajnime nga KQZ-ja për të adresuar këtë mangësi të përsëritur në procesin zgjedhor para këtyre zgjedhjeve.

Këto ishin zgjedhjet e para parlamentare në Kosovë ku OSBE-ja nuk ofroi ndonjë ndihmë teknike për KQZ-në. Në zgjedhjet e mëparshme, OSBE caktoi stafin në një rol këshillues në Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe në të gjitha Këshillat e Vendvotimeve në katër komunat serbe në veri të Kosovës.

VII. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Përkundër disa përmirësimeve, regjistrimi i votuesve ende i mungon saktësia

Çdo qytetar që ka mbushur moshën 18 vjeç ka të drejtë vote të garantuar me Kushtetutë.⁸ Pranueshmëria e votës është edhe më gjithëpërfshirëse pasi që legjislacioni i Kosovës u jep të drejtën e votës edhe atyre që nuk janë shtetas të Kosovës e të cilët e gëzojnë të drejtën për shtetësi të Kosovës.

⁸ Votuesit që janë të paaftë për të vepruar/votuar me vendim të gjykatave përjashtohen nga lista e votuesve.

Kosova ka një sistem pasiv të regjistrimit të votuesve përmes së cilit listat preliminare dhe përfundimtare të votuesve përpilohen nga KQZ-ja bazuar në regjistrat e siguruar nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Lista përfundimtare e votuesve (LPV) u certifikua nga KQZ më 2 shkurt dhe përfshin 1,794,862 votues. Kjo shifër nuk përfshin rreth 102,100 votues të cilët u regjistruan për të votuar jashtë Kosovës pasi shumica e tyre u përjashtuan nga LPV dhe u shtuan në listën e posaçme për të votuar jashtë Kosovës.⁹

KQZ-ja mori disa vendime për të rritur saktësinë e LPV, por nuk ekziston asnjë sistem për të siguruar që të gjithë njerëzit e vdekur që janë në listën e votuesve të hiqen nga lista. KQZ fshiu para zgjedhjeve nga LPV rreth 11,000 njerëz të vdekur; ajo gjithashtu largoi 122,421 persona në posedim të letërnjoftimeve të UNMIK-ut që kurrë nuk morën ndonjë nga dokumentet e Kosovës të nevojshme për të identifikuar votuesit në qendrat e votimit. Sipas ARC, kishte 1,682,187 letërnjoftime të vlefshme të Kosovës në qarkullim të lëshuara deri në dhjetor të vitit 2020.¹⁰ Një numër i panjohur por supozohet të jetë një përqindje e vogël e banorëve serbë në veri të Kosovës, ende nuk kanë letërnjoftime të Kosovës dhe për këtë arsye nuk ishin në gjendje të marrin pjesë në këto zgjedhje. Lista e votuesve në Kosovë përmban një numër të madh të njerëzve që kanë banim të përhershëm jashtë vendit pasi shumica dërrmuese e kosovarëve të diasporës mbeten të regjistruar në mënyrë të ligjshme në regjistrin civil i cili shërben si bazë për listën e votuesve. Numri i lartë i njerëzve në diasporë me banim të përhershëm jashtë vendit dhe i votuesve të vdekur në listën e votuesve e bën procesin e votimit të cenueshëm ndaj abuzimeve të mundshme, duke ndikuar negativisht në besimin ndaj procesit. Megjithatë, në mungesë të ndonjë të dhëne të besueshme për popullsinë e diasporës si dhe për numrin e njerëzve të vdekur, nuk është e mundur të bëhet një vlerësim i plotë i shkallës së mangësive në listën e votuesve dhe në saktësisë së saj të përgjithshme.

Numri i votuesve të regjistruar më parë ishte në rritje të vazhdueshme midis zgjedhjeve pasi numri i votuesve të rinj të cilët mbushën 18 vjeç dhe numri i shtetasve të regjistruar gjithmonë ishin më të shumtë se numri i përgjithshëm i votuesve të hequr nga lista e votuesve për shkak të vdekjes ose heqjes dorë nga shtetësia. Megjithatë, për shkak se KQZ vendosi të pastrojë listën e personave që posedojnë vetëm dokumente të UNMIK-ut, Lista Përfundimtare e Votuesve përmban më pak votues sesa lista e votuesve e vitit 2019.

Votimi jashtë Kosovës

Regjistrimi i votuesve dhe periudha e votimit jashtë Kosovës u ndikua negativisht nga afati i shkurtër kohor dhe në të njëjtën kohë kishte afërsisht tre herë më shumë aplikantë në krahasim me zgjedhjet e mëparshme, dhe mendohet gjerësisht se është rezultat i një fushate nga LVV e cila

⁹ Bazuar në ligj, votuesit që janë në ARC dhe janë regjistruar për të votuar jashtë Kosovës përjashtohen nga LPV e përpiluar nga KQZ. Ekzistojnë dy kategori të ndryshme të votuesve në lidhje me regjistrimin e votuesve: Votuesit jashtë Kosovës që janë në bazën e të dhënave në ARC dhe përfshihen në listën e përkohshme të votuesve dhe ata votues jashtë Kosovës që nuk janë në listën e votuesve të Kosovës por që kanë të drejtë të votojnë pasi të regjistrohen me sukses në listën e votuesve jashtë Kosovës.

¹⁰ Sipas rregullave të KQZ-së, lista e votuesve kërkohet të pastrohet nga votuesit të cilëve u është hequr e drejta për të vepruar/votuar me vendim të gjykatave. Kjo kërkon që Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ta njoftojë KQZ-në për identitetin e këtyre personave. Bazuar në listën e KGJK-së, KQZ-ja ka pastruar rreth 150 votues nga lista e votuesve.

është përfituesja më të madhe e votimit jashtë Kosovës.¹¹ Votuesit kishin vetëm 12 ditë për të aplikuar për regjistrim në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe KQZ nuk ishte në gjendje të shqyrtonte të gjitha 130,168 aplikimet në kohën e duhur. Prandaj, ndryshe nga lista e rregullt e votuesve, lista e votuesve jashtë Kosovës nuk ishte në dispozicion për kontroll publik gjatë periudhës së konfirmimit dhe kundërshtimit më 25-27 janar. Lista përfundimtare e votuesve jashtë Kosovës u përpilua më 2 shkurt dhe më pas u certifikua nga KQZ. Aplikantët e refuzuar kishin vetëm një ditë për të parashtruar ankesë ndaj rezultateve të procesit të regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, i cili kufizoi të drejtën e tyre për mjete efektive juridike.¹²

KQZ-ja futi në përdorim një kërkesë disi arbitrare - verifikimin e aplikantëve / votuesve përmes thirrjeve telefonike. KQZ-ja rekrutoi një numër të madh të personelit që punoi në ndërrime për të telefonuar / verifikuar të gjithë aplikantët. Përkundër përpjekjeve të konsiderueshme, rreth 37,896 aplikantë nuk u verifikuan përmes thirrjeve telefonike, por megjithatë u konfirmuan, duke ilustruar papërshtatshmërinë e kësaj mase si një mbrojtje ndaj mashtrimit. Nga të gjitha thirrjet, vetëm rreth 290 aplikacione nuk u miratuan nga KQZ pasi personat e kontaktuar gjatë verifikimit konfirmuan që ata nuk kishin aplikuar. Vendimi fillestar i KQZ-së për të mos regjistruar aplikimet në rast se aplikantët nuk iu përgjigjën thirrjeve të KQZ-së nuk do të kishte qenë e bazuar në ligj dhe do të kishte çuar në heqjen e të drejtës së votimit për shumë votues.

Pas vlerësimit të 130,168 aplikacioneve për regjistrim si votues jashtë Kosovës që KQZ-ja i mori nga data 13 deri më 21 janar, 102,100 u miratuan. Arsyet kryesore për refuzimin e aplikacioneve të mbetura ishin që aplikantët nuk ishin në gjendje të dëshmoni identitetin e tyre, nuk plotësonin kriteret e aftësisë ligjore ose nuk kishin nënshkruar aplikacionet e tyre.

Numri i votuesve që ishin regjistruar për votim jashtë Kosovës ishte dukshëm më i lartë krahasuar me zgjedhjet e mëparshme.¹³ Votimi jashtë Kosovës filloi në të njëjtën ditë (një ditë më vonë sesa ishte parashikuar fillimisht) por vetëm pasi fleta e votimit dhe broshura e miratuar me listat e kandidatëve u botuan në faqen e internetit të KQZ-së.¹⁴ Shumica dërmuese e aplikantëve (gati 70 përqind) ishin nga Gjermania dhe Zvicra.¹⁵ Ka pasur një rënie të ndjeshme të aplikimeve nga Serbia (vetëm 160 aplikacione janë aprovuar nga më pak se 300). Kjo rënie mund të shpjegohet pjesërisht me çështjen e mosnjohjes së shërbimeve përkatëse postare dhe një vendimi të mëparshëm të gjykatave për të mos numëruar fletëvotimet nga Serbia që ishin dorëzuar përmes postës brenda në Kosovë.¹⁶

¹¹ Numri i aplikantëve për votim jashtë Kosovës u rrit nga 20,354 për zgjedhjet parlamentare 2017 në 40,313 në 2019 dhe në 131,500 për zgjedhjet parlamentare 2021.

¹² Vetëm rreth 100 aplikantë ishin të suksesshëm në ankesat e parashtruara në PZAP kundër refuzimeve të aplikacioneve të tyre.

¹³ 102,100 votues të aprovuar për të votuar jashtë Kosovës më 2021 krahasuar me 35,087 votues të aprovuar më 2019.

¹⁴ Votimi jashtë Kosovës filloi në të njëjtën ditë, por fleta e votimit u certifikua rreth orës 6 pasdite, kështu që votuesit mund ta shkarkonin atë dhe të fillonin të votonin pas asaj kohe.

¹⁵ Këto janë shtatë vendet me numrin më të lartë të votuesve të regjistruar për të votuar jashtë Kosovës: Gjermani 43,049, Zvicër 26,686, Austri 4,758, Francë 4,164, Suedi 4,069, Itali 3,487, Mbretëria e Bashkuar 2,448 dhe të tjerët.

¹⁶ Përfaqësuesi i Listës Srpska në KQZ nuk dha ndonjë shpjegim për një ulje kaq të konsiderueshme të numrit të aplikacioneve nga Serbia. Në vitin 2019 votat jashtë Kosovës që vinin nga Serbia u dërguar në Kosovë dhe u vendosën në një zyrë postare të Kosovës.

Periudha e votimit dhjetë ditësh (2-12 shkurt) jashtë Kosovës është jashtëzakonisht e shkurtër dhe çon në heqjen e të drejtës së votës për votuesit. KQZ vendosi të përcaktojë afatin e fundit më 12 shkurt për marrjen e zarfeve / fletëve të votimit që vijnë nga votimi jashtë Kosovës bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 2 shkurt 2021 për të pranuar votat jashtë Kosovës vetëm nëse merren një ditë para ditës së zgjedhjeve. Përfaqësuesit e LVV në KQZ kritikuan vendimin pasi afati mund të ishte caktuar për datën 13 shkurt pasi votat do të numëroheshin vetëm duke filluar nga ora 7 e pasdites në ditën e zgjedhjeve.¹⁷ Një vendim i Gjykatës Kushtetuese, i cili anulon vendimin e Gjykatës Supreme të vitit 2019, i referohet LZP si bazë për vendimin e saj; megjithatë, gjatë zgjedhjeve të mëparshme, Gjykata Supreme vendosi që votat jashtë Kosovës të pranohen dhe të numërohen nëse ato do të dërgoheshin me postë para ditës së zgjedhjeve pavarësisht se a mbërrijnë në zyrën postare disa ditë pas ditës së zgjedhjeve, gjatë procesit të rinumërimit dhe numërimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Më shumë se 9,000 pako postare arritën në KQZ pas përfundimit të afatit.

Për më tepër, kishte një polemikë në lidhje me pranimin e shërbimeve të postës së shpejt (të tilla si DHL, UPS, TNT) të cilat nuk e dorëzojnë postën e tyre në një kuti postare të KQZ-së, por tek një zyrë ose person i caktuar. Sekretariati i KQZ-së në mënyrë të arsyeshme vendosi që letrat postare të shërbimit të shpejt duhet të mbahen derisa zyrtarët e autorizuar të KQZ-së t'i marrin dhe t'i transportojnë ato në ambientet ku mbaheshin letrat postare të votimit jashtë Kosovës, deri në ditën e fundit para zgjedhjeve.

VIII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Kontradiktat mbi decertifikimin e kandidatëve të dënuar dhe pretendimet për listat jo të vërteta të kandidatëve jo-shumicë

E drejta për të garuar në zgjedhje i është dhënë të gjithë votuesve me të drejtë vote. Disa mbajtës të posteve publike, duke përfshirë gjykatësit, ushtarakët dhe oficerët e zbatimit të ligjit, diplomatët dhe shefat e agjencive të pavarura, u kërkohet të japin dorëheqjen për të kandiduar. LZP skualifikon për tri vjet ata që janë dënuar për çfarëdo veprë penale, pas vendimit të formës së prerë të gjykatës.¹⁸ Përderisa përjashtimi i shkelësve të ligjit nga parlamenti i shërben një qëllimi legjitim, skualifikimi, pavarësisht nga pesha e krimit është joproporcional dhe në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.¹⁹ Për më tepër, LZP nuk është e harmonizuar me Kushtetutën e cila kërkon një vendim gjykatë që privon shprehimisht të drejtat e votës dhe Kodin Penal që skualifikon vetëm ata të dënuar për vepra elektorale ose vepra të dënueshme me burgim për më shumë se dy

¹⁷ Shumica e votuesve jashtë Kosovës votuan për LVV në zgjedhjet e mëparshme parlamentare.

¹⁸ Shih nenin 45.1 të Kushtetutës, nenin 29 të LZP dhe nenin 60 të Kodit Penal.

¹⁹ Pjesa I.1.1.d e Kodit të Komisionit të Venecias e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore deklaron se: “i. Mund të miratohen dispozita për privimin e individëve nga e drejta e tyre për të votuar apo për t'u zgjedhur, por vetëm në rast se ekzistojnë të gjitha kushtet e mëposhtme: ii. Duhet patjetër të parashikohet me ligj. iii. Duhet të respektohet parimi i proporcionalitetit; kushtet për privimin e individëve nga e drejta për t'u zgjedhur mund të jenë më pak strikte se sa kushtet për privimin e tyre nga e drejta për të votuar. iv. Privimi mund të aplikohet në rastin e paaftësisë mendore ose të dënimit nga gjykata për një veprë të rëndë penale. v. Përveç kësaj, abrogimi i të drejtave politike ose përcaktimi i paaftësisë mendore mund të aplikohet vetëm me vendim të posaçëm gjykatë.” Shih gjithashtu paragrafët 137-139, 150-151 të Komisionit të Venecias, Raport për Përjashtimin e Shkelësve të Ligjit nga Parlamenti.

vjet. Kushtetuta parasheh gjithashtu që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara mund të kufizohen vetëm me ligj.

Rekomandimi: Të përcaktohet papërshtatshmëria e kandidatit vetëm për një dënim penal të formës së prerë për veprat e rënda penale dhe në përputhje me një vendim të gjykatës i cili shprehimisht privon individin e dënuar nga e drejta e kandidimit. Të harmonizohen dispozitat e zbatueshme në ligjin zgjedhor dhe kodin penal.

Për të garuar në zgjedhje, partitë politike, koalicionet, iniciativat e qytetarëve dhe kandidatët e pavarur duhet të certifikohen nga KQZ si subjekte politike. Përderisa partitë politike të regjistruara certifikohen automatikisht, atyre të paregjistruara u kërkohet të aplikojnë më së voni 60 ditë para zgjedhjeve, me këtë duke e bërë të pamundur certifikimin e partive të reja, në rast të zgjedhjeve të parakohshme. Partive jo parlamentare, përfshirë ato që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë, u kërkohet të paguajnë një tarifë certifikimi prej 2,000 euro dhe të dorëzojnë 1,000 nënshkrime të votuesve. Në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare, një votues mund të nënshkruajë mbështetjen e vetëm një liste.²⁰ Nga subjektet e certifikuar politike kërkohet të dorëzojnë listat e tyre të kandidatëve për certifikim. Kuota gjinore prej 30 përqind është e zbatueshme si për listat e kandidatëve ashtu edhe për caktimin e vendeve në Kuvend, të plotësuara me një kërkesë për vendosjen për listat e kandidatëve.

KQZ-ja ka mandat të regjistroj partitë politike dhe certifikoj subjektet politike dhe listat e kandidatëve për zgjedhje. Gjithsej 28 subjekte politike dhe 1,052 kandidatë që aplikuan u certifikuan. KQZ-ja menaxhoi mirë regjistrimin e kandidatëve, përkundër një afati të shkurtuar dhe mospajtimeve rreth certifikimit të kandidatëve të dënuar. Prej tyre, shtatë përfaqësojnë komunitetin shqiptar të Kosovës, tre komunitetin serb të Kosovës, pesë boshnjakë të Kosovës, katër romë të Kosovës, dy egjiptianë të Kosovës, tre ashkali të Kosovës, dy turq të Kosovës dhe dy goranë të Kosovës.

Kandidatëve të mundshëm u kërkohet të nënshkruajnë një formular certifikimi që konfirmon se plotësojnë të gjitha kriteret e pranueshmërisë, por nuk u vendosën sanksione për deklarime të rreme nga kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat ligjore, siç kërkohet me ligj. Nga KQZ kërkohet që të verifikojë pranueshmërinë e kandidatëve, përfshirë edhe duke kërkuar informata nga institucionet përkatëse shtetërore.²¹ Pas një kërkesë të KQZ-së, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) paraqiti një listë me 47 kandidatë të dënuar në nëntë lista.²² Duke u bazuar në kërkesën e KQZ-së, tre lista

²⁰ Paragrafi 77 i Udhëzimeve 2010 ODIHR dhe të Komisionit të Venecias për Rregulloren e partive politike: “për të rritur pluralizmin dhe lirinë e asociimit, legjislati nuk duhet të kufizojë një qytetar në nënshkrimin e një liste mbështetëse të vetëm një partie. Një kufizim i tillë abuzohet shumë lehtë dhe mund të çojë në skualifikimin e partive të cilat në mirëbesim besuan se kishin përmbushur kërkesat për regjistrim.”

²¹ Përfshirë MPJ, Policinë, Zyrat e Doganave, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe institucionet e tjera publike.

²² Në zgjedhjet komunale të vitit 2017, Gjykata Supreme vendosi që individëve të dënuar nuk u hiqet e drejta për të kandiduar, përveç nëse gjykata shqipton skualifikimin si një dënim plotësues, siç kërkohet me Kushtetutë. Përderisa Gjykata urdhëroi KQZ-në të certifikonte tre kandidatë që paraqitën ankesa, KQZ certifikoi të gjithë 87 kandidatët fillimisht të de-certifikuar. Për zgjedhjet parlamentare të vitit 2019, KQZ-ja nuk hulumtoi nëse të emëruarit kishin dënime penale dhe asnjë kandidat nuk u de-certifikua për këto arsye.

zëvendësuan 20 kandidatë të dënuar.²³ Rrjedhimisht, KQZ votoi për de-certifikimin e gjashtë listave të cilat nuk ishin të pajtueshme, duke përfshirë listën e LVV dhe bartësin e saj ish kryeministrin Albin Kurti.²⁴ Pas ankesave, të gjashtë listat u certifikuan pa 24 kandidatët e tyre të dënuar, por ata refuzuan të ri-renditnin kandidatët e mbetur, duke lejuar që në praktikë votuesit të votonin për kandidatët e certifikuar.²⁵ Në përputhje me ligjin, KQZ njoftoi se fletëvotimet me vota preferenciale të hedhura për kandidatë të de-certifikuar do të llogarritnin vetëm për subjektin politik.

Një kandidat i një subjekti politik që përfaqëson komunitetin boshnjak të Kosovës u de-certifikua nga PZAP për arsyet se ai ishte i etnitetit shqiptar më parë sesa boshnjak.²⁶ Ky vendim nuk ishte në përputhje me ligjin, i cili as nuk kërkon që kandidatët e një subjekti politik jo-shumicë t'i përkasin komunitetit specifik dhe as që ata të paraqesin ndonjë vetë-deklarim formal për përkatësinë etnike.²⁷ Për më tepër, bashkëbiseduesit e MEZ BE pretenduan se disa subjekte politike të regjistruara si përfaqësuese të komuniteteve jo-shumicë nuk e përfaqësonin vërtet atë komunitet, por synonin të përfitonin padrejtësisht nga vendet e garantuara në Kuvend në mënyrë që të forconin mbështetjen politike të një komuniteti tjetër.²⁸ Megjithatë, nuk ka kritere të qarta dhe objektive në ligj që përcaktojnë nëse një subjekt politik përfaqëson një komunitet jo-shumicë. Gjithashtu, votuesit që i përkasin një komuniteti të caktuar jo-shumicë nuk janë të kufizuar në votimin e një subjekti politik që përfaqëson komunitetin e tyre.

IX. AMBIENTI I FUSHATËS

Fushata konkurruese dhe e gjallë në pjesën më të madhe të Kosovës; kishte një mungesë të konkurrencës në komunitetin serb të Kosovës

Një periudhë fushate 10-ditore për zgjedhjet e parakohshme (krahësuar me 30 ditë në rastin e zgjedhjeve të rregullta) filloi më 3 shkurt dhe zgjati deri më 12 shkurt, e ndjekur nga një ditë heshtje zgjedhore para ditës së zgjedhjeve të 14 shkurtit. Kandidatët filluan aktivitete të ngjashme

²³ PDK, LDK dhe SL u binden derisa LVV, AAK, Iniciativa Social Demokratike-NISMA, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), Partia Ashkalive për Integrim (PAI) dhe Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) nuk i zëvendësuan kandidatët.

²⁴ Në vitin 2018, Kurti mori një dënim me kusht me 15 muaj burgim për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvend në shenjë proteste kundër demarkacionit të kufirit me Malin e Zi për të cilin LVV pretendoi se e privoi Kosovën nga territori. LVV protestoi në të njëjtën mënyrë kundër krijimit të Asociacionit/Komunitetit të Komunave me shumicë Serbe.

²⁵ Fletëvotimi përmban një listë të subjekteve politike në anën e majtë dhe kutitë me numra nga 1-110 në anën e djathtë. Votueset i ofrohet një broshurë me listat e 28 kandidatëve me numra në mënyrë që të identifikojnë kandidatët e tyre të preferuar dhe të shënojnë numrat përkatës në fletëvotim. Pas de-certifikimit të kandidatëve të dënuar, listave të LVV dhe AAK u mungojnë tre emra secili, NISMA 12 dhe PDAK dhe NDS nga një emër secili. Për shembull, votuesit e LVV-së ende kishin mundësi të shënojnë kutinë numër një për kandidatin e de-certifikuar Kurti.

²⁶ Gjegjësisht, Emin Neziraj nga Nova Demokratska Stranka (NDS) (*Shih zgjidhja e mosmarrëveshjeve*).

²⁷ Shih pjesën 2.2.4.c [Kodit të Komisionit të Venecias i Praktikës së Mirë](#): “As kandidat e as votues nuk duhet të gjenden në situatë ku janë të detyruar të tregojnë anëtarësinë e tyre të një pakice kombëtare.”

²⁸ Subjektet e pretenduara që nuk janë vërtetë jo-shumicë ishin Komuniteti i Bashkuar Boshnjak i Kosovës - Nisma Qytetare (UZ - AH) e udhëhequr nga Adriana Hodžić dhe iniciativa e Romëve (RI) e udhëhequr nga Gazmend Salijević.

me fushatën shumë kohë para 3 shkurtit. Të gjitha subjektet kryesore garuese *de facto* zhvilluan fushata, përfshirë aty grumbullimet relativisht të mëdha të mbështetësve që nga gjysma e dytë e janarit, pas heqjes së pjesshme të ndalesave për takimet publike lidhur me pandeminë COVID-19.²⁹ Disa subjekte filluan aktivitete të tilla edhe para 15 janarit, siç shihej në postimet e mediave sociale të partive, ku në disa raste e kanë shpërfillur rregulloren e sigurisë publike në fuqi.

Këto ishin zgjedhje me konkurrencë dhe fushata ishte e gjallë, e përbërë nga një numër i madh tubimesh dhe takime derë më derë, edhe pse kishte disa kufizime në lidhje me pandeminë. Aktivitetet e fushatës së kandidatëve disa herë përfshinin mbledhje relativisht të mëdha të mbështetësve, duke i shkelur rregulloret e sigurisë publike që lidheshin me COVID-19.³⁰ Shumë gjëra ishin vendimtare për shumë parti, gjë që ka çuar në një ambient të tensionuar parazgjedhor në mes të partive shqiptare të Kosovës dhe retorikë të ashpër.

Për dallim prej zgjedhjeve të mëparshme, partitë kryesore nuk krijuan koalicione parazgjedhore. Kandidatët shqiptarë të Kosovës ishin në gjendje të bënë fushatë të lirë, në kuadër të kufijve të vendosur nga kufizimet e shëndetit publik, me përjashtim të dy incidenteve të vogla në lidhje me vizitat e Albin Kurtit në Skenderaj dhe Mitrovicën Veriore (së bashku me Vjosa Osmanin) disa ditë para fillimi i periudhës së fushatës. Në komunat e Kosovës me shumicë serbe fushata ishte më e zbehtë dhe partitë opozitare të Srpska Lista ishin mezi të dukshme dhe pretenduan se mbështetësit e tyre kishin frikë të merrnin pjesë në organizimet e tyre të fushatës duke deklaruar raste të presionit dhe frikësimit kundër kandidatëve jo-SL dhe mbështetësit e tyre gjatë zgjedhjeve të kaluara. Srpska Lista në aktivitetet e saj të fushatës kryesisht u përqendrua në aktivitete në shkallë të ulët dhe fushata derë më derë duke respektuar rregullat e pandemisë.

Rimëkëmbja ekonomike ishte në qendër të programeve të fushatës, praktikisht e të gjitha partive, duke përfshirë premtime dukshëm joreale si rritja e ndjeshme e pagës minimale, pensione, etj. Lufta kundër korrupsionit ishte gjithashtu një temë qendrore në programet e kandidatëve së bashku me sundimin e ligjit, përfshirë në platformat e AAK-së, PDK-së dhe LVV-së. LDK i dha prioritet shëndetësisë dhe arsimit. Dialogu me Serbinë u përmend në programet zgjedhore, por vetëm në një mënyrë të përgjithshme dhe pa propozime konkrete.

Subjektet garuese informuan MEZ se ata kishin përshtatur strategjitë e tyre të fushatës me pandeminë COVID-19, pasi tubimet e mëdha nuk mund të zhvilloheshin. Përveç takimeve me përmasa më të vogla të realizuara në tërë Kosovën nga të gjitha partitë dhe kandidatët kryesorë, subjektet garuese shfrytëzuan edhe platformat online shumë më tepër dhe mediat sociale në veçanti luajtën një rol kryesor në kontaktimin e votuesve potencial. Disa parti gjithashtu filluan të


²⁹ Para 15 janarit, ishin të ndaluar takimet në hapësira të mbyllura si dhe takimet jashtë me më shumë se 4 persona si masë që synonte të frenojë përhapjen e COVID-19; që nga 15 janari, u lejuan takimet e deri në 30 personave në hapësira të mbyllura dhe tubimet e deri 50 personave në vende publike jashtë. Masat që synonin frenimin e përhapjes së virusit përfshinin bartjen e maskave në institucione private dhe publike, distancë shoqërore, etj. Gjithashtu kishte orë policore nga ora 21:30 deri në orën 05:00 dhe ndalim të hyrjes/daljes në komunat me rrezik të lartë (mbi 150 persona të infektuar në 100,000 banorë në javë).

³⁰ Të gjitha partitë shqiptare të Kosovës të përfaqësuara në Kuvend pranuan se i kanë shkelur rregullat e COVID-19. Komuna e Prishtinës lëshoi disa gjopa (minimum 2,000 Euro) për mosrespektim të masave anti-COVID.

vendosnin reklama me pagesë në transmetimet tradicionale të mediave, por dukshëm më pak në krahasim me zgjedhjet e mëparshme.

Fushata Zgjedhore në Mediat Sociale


Të gjitha palët garuese kishin grupe të ndjekësve të partive në mediat sociale, kryesisht që merreshin me aktivitetet e partive. Të gjitha partitë kryesore gjithashtu kanë faqe të degëve të tyre në komuna të ndryshme të cilat kanë një rreth të vogël deri te ai i mesëm i ndjekësve (mesatarisht 1,000-2,000 ndjekës). Faqja zyrtare e LVV në Facebook ka dukshëm numrin më të madh të ndjekësve krahasuar me partitë e tjera.³¹



Derisa LVV dominoi qartë hapësirën online me numrin më të madh të ndjekësve dhe numrin e angazhimeve/ndërveprimeve të përdoruesve, kjo parti dhe kandidatët e saj ishin më pak aktiv sa i përket sasisë së postimeve në krahasim me subjektet e tjera politike. Megjithatë, gjatë 30 ditëve para ditës së zgjedhjeve, numri më i madh i ndërveprimeve në Facebook u regjistrua nga kandidatja kryesore e LVV Vjosa Osmani (1.43 milion.) dhe udhëheqësi i LVV Albin Kurti (1 milion.). Ata u pasuan nga Ramush Haradinaj - AAK (630 mijë), Avdullah Hoti - LDK (470 mijë), Enver Hoxhaj - PDK (450 mijë) dhe Behgjet Pacolli - LDK (210 mijë).³²


³¹ Përveç profileve të rregullta të kandidatëve dhe partive në mediat sociale, grupet dhe faqet më të rëndësishme dhe në dukje më të fuqishme ("fan pages") janë ato që përfshijnë ndjekës të partive të përgjithshme nga e gjithë Kosova si "LDK për Kosovën" e cila ka një numër prej rreth 27,500, #PDKperKOSOVEN me rreth 5,700, dhe "meKryeministrin" (duke aluduar tek Albin Kurti). Grupi i ndjekësve të LVV ka një numër dukshëm më të lartë, që arrin në rreth 326,000. Ky grup me ndikim i admiruesve duket se përfshin një numër të madh të votuesve të diasporës pasi shumë postime në periudhën parazgjedhore kishin të bënin me çështjet që lidhen me votimin jashtë Kosovës.

³² Behgjet Pacolli është politikan kosovar me ndjekjen më të madhe në Facebook (524 mijë), i ndjekur nga Albin Kurti (474 mijë) dhe Hashim Thaçi (360 mijë) (të dhëna të shkurtit 2021).



Prania dominuese online e akterëve të LVV-së u pasqyrua gjithashtu në shkallën e përgjithshme të ndërveprimeve në postimet e caktuara. Kur analizohen 30 ditët para ditës së zgjedhjeve, nga 50 postimet me popullaritet nga kandidatët kryesorë ose udhëheqësit e partive, Albin Kurti dhe Vjosa Osmani ishin personazhe në 90 përqind të tyre, përfshirë 27 postimet e para me më së shumti popullaritet, të cilat në përgjithësi nuk ishin shtytur përmes reklamave të paguara.

Ashtu si në periudhën para fushatës, edhe në fushatën zyrtare, partia me më shumë reklama ishte AAK (nga faqja e partisë në Facebook), ndërsa kandidatët e partive të tjera kryesore kishin një numër përafërsisht të ngjashëm të reklamave të sponsorizuara.³³ Përfundim ishte LVV, ku kandidatët kryesorë të tyre postuan shumë pak reklama me pagesë. Kandidatët filluan të sponsorizojnë reklama shumë kohë para fillimit zyrtar të fushatës më 3 shkurt.



³³ MEZ BE gjurmoi manualisht reklamat e paguara të kandidatëve në Facebook, i cili ende nuk ka implementuar për Kosovën setin e plotë të veglave që lehtësojnë transparencën dhe llogaridhënien e reklamave politike; për këtë ishte e mundur vetëm të shihej sasia e reklamave nga akterët kryesorë politikë (faqet e Facebook të cilëve u monitoruan nga misioni) por jo shumta e fondeve të shpenzuara.

Financimi i Partisë dhe Fushatës

Financimi i partive dhe fushatave rregullohet me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP) të vitit 2010, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) i vitit 2008 si dhe Rregulloret e KQZ-së.³⁴ Korniza aktuale rregulluese, siç zbatohet aktualisht, nuk siguron transparencën e financimit të fushatës. Veçanërisht, ligji kërkon raportimin e financimit të fushatës për një periudhë që fillon 90 ditë para ditës së zgjedhjeve, por KQZ-ja kufizoi raportimin vetëm në 10 ditët e fushatës së "rregulluar", gjë që zvogëloi transparencën.³⁵ Një projektligj për financimet politike, i cili u vlerësua si "një hap i rëndësishëm në drejtimin e duhur", në pritje që nga viti 2019, kaloi leximin e parë në Kuvend në tetor 2020.³⁶

Një subjekt politik mund të shpenzojë deri në 0.5 euro për votues të regjistruar, që arrin në 897,431 euro në nivel të gjithë Kosovës. Subjektet politike në Kuvend marrin fonde publike, të alokuara çdo vit, proporcionalisht me numrin e ulëseve të tyre.³⁷ Financimi publik për fushatë nuk është i detyrueshëm dhe nuk ishte alokuar për këto ose për ndonjë palë zgjedhje të mëparshme. Subjektet politike gjithashtu mund të financohen nga aktivitetet e tyre jofitimprurëse, tarifat e anëtarësisë në parti dhe donacionet private. Një individ mund të jep donacion subjektit politik deri në 2,000 Euro në vit ndërsa një subjekt juridik deri në 10,000 euro, por nuk ka asnjë mekanizëm për identifikimin e donacioneve të shumta që tejkalojnë kufirin e lejueshëm. Donacionet gjithashtu mund të jenë në të mira materiale (në natyrë), por nuk ka asnjë metodologji për vlerësimin e tyre. Ligji ndalon burime të caktuara donacionesh, përfshirë nga burimet e huaja dhe anonime, organizatat joqeveritare, bamirëse dhe fetare, ndërmarrjet publike dhe kompanitë private me kontrata të prokurimit publik. Megjithatë, nuk ka asnjë mekanizëm për të verifikuar pajtueshmërinë me këto ndalesa. Përderisa çdo subjekt politik kërkohet të pranojë të gjitha të ardhurat dhe të realizojë të gjitha shpenzimet me transfer bankar përmes një llogarie të vetme bankare të një partie, transaksionet në para janë të zakonshme.

Subjekteve politike u kërkohet të paraqesin raportet e financave të fushatës në KQZ brenda 45 ditëve pas ditës së zgjedhjeve, gjë që nuk ofron transparencë dhe mbikëqyrje para ditës së zgjedhjeve. Raportet dorëzohen në një formular të standardizuar të KQZ-së, i cili nuk kërkon informata të ndara, dhe nuk publikohen në një mënyrë lehtësisht të qasshme.³⁸ Përderisa subjekteve politike u kërkohet të publikojnë raportet e tyre vjetore dhe raportet e financimit të

³⁴ Gjegjësisht, Rregullat e KQZ-së Nr. 12/2013 për Kufizimin e Shpenzimeve të Fushatës dhe Deklarimi Financiar dhe Nr. 14/2015 për Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet.

³⁵ Nenet 44-53 të LZP (Kapitulli VII dhe VIII) përmbajnë rregulla për subjektet politike dhe mediat të zbatueshme gjatë fushatës zgjedhore, që synojnë të sigurojnë kushte të barabarta për kandidatët. Periudha e raportimit të financave të fushatës fillon 90 ditë para ditës së zgjedhjeve, siç përcaktohet në nenin 40.1 të LZP (Kapitulli V).

³⁶ Shih Mendimin e Komisionit të Venecias 922/2018 për Projektligjin për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-174 për Financimi i Subjekteve Politike. Ky projektligj tashmë ka kaluar leximin e parë dy herë, për shkak të shpërndarjes së Kuvendit dy herë, dhe do të duhet ta kalojë për herë të tretë në Kuvendin e ri.

³⁷ Me Vendimin e KQZ-së 174/2021 të datës 19.01.2021, 630,000 euro u alokuan 14 subjekteve politike, për janar dhe shkurt 2021 si më poshtë: 152,250 për LVV; 147,000 për LDK; 126,000 për PDK; 68,250 për AAK-PSD; 31,500 për NISMA; 52,500 për SL; 10,500 për KDTP; 10,500 për VAKAT; 5,250 çdonjëres nga gjashtë partitë e tjera jo-shumicë (NDS, PLE, IRDK, JGP, PAI, PREBK). 3.57 milion eurot e mbetura do të alokohen bazuar në numrin e ulëseve në Kuvendin e ri.

³⁸ Si KQZ ashtu edhe partitë publikojnë kopje të skanuara të raporteve financiare.

fushatës në faqet e tyre të internetit, edhe pse disa parti nuk e kanë bërë këtë, ndaj tyre nuk kishte sanksione.

Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike të Kuvendit (këtu e tutje Komisionit) i kërkohet të kontrakttojë auditimin e raporteve financiare të auditorët e jashtëm të certifikuar. Shumë bashkëbisedues të MVZ-së nga BE ngritën shqetësime në lidhje me konfliktin e mundshëm të interesave dhe mungesën e kapacitetit të Komisionit për të kryer rolin e tij mbikëqyrës.³⁹ Ligji kërkon që auditimi të përfundojë brenda 75 ditëve nga dorëzimi i raporteve financiare. Megjithatë, në rast të zgjedhjeve të parakohshme, auditorët mund të emërohen vetëm në vitin pas zgjedhjeve dhe kështu auditimi për këto zgjedhje nuk mund të përfundojë para qershorit 2022.⁴⁰ Përveç auditimit të vonshëm, auditorëve u kërkohet të verifikojnë përmbajtjen e raporteve financiare, por jo të identifikojnë të ardhurat dhe shpenzimet e pa raportuara.

Nga KQZ kërkohet të pranojë dhe publikojë raportet vjetore dhe të financimit të fushatave të subjekteve politike në faqen e saj të internetit.⁴¹ Në të kaluarën, me një interpretim të ngushtë të ligjit, KQZ-ja ka publikuar këto raporte vetëm pas auditimit, gjë që vonoi ndjeshëm deklarin. ⁴² Si një hap pozitiv, në vitin 2020, KQZ-ja publikoi raportet vjetore financiare të vitit 2019 dhe ato të fushatës, edhe pse nuk ishin të audituara. Megjithatë, raportet u botuan si fotografi të skanuara, të cilat nuk janë miqësore për përdoruesit, pasi që nuk mund të bëhet kërkimi në to. Nga KQZ gjithashtu kërkohet të publikojë një regjistër të donatorëve, me informacion mbi të gjitha donacionet e bëra subjekteve politike, por nuk ka afate për ta bërë këtë dhe një regjistër i tillë nuk është botuar kurrë. Sipas ligjit, KQZ-ja mund të vendosë sanksione për parregullsi, përfshirë edhe mosparaqitjen e një raporti financiar dhe keqpërdorimin e burimeve shtetërore për fushatë. Megjithatë, KQZ-ja nuk ka burime të mjaftueshme dhe nuk i është dhënë me ligj asnjë kompetencë hetimore për të identifikuar parregullsitë. Për më tepër, disa bashkëbisedues të MVZ-së nga BE ishin të mendimit se sanksionet ekzistuese (kryesisht gjohet që ndryshojnë nga 1,000 deri në 5,000 euro) nuk janë dekurajuese dhe efektive krahasuar me shumën në fjalë në fushën e financimit të partive.⁴³

³⁹ Komisioni dështoi në emërimin auditorëve për shkak të tenderëve publik të pasuksesshëm. Rrjedhimisht, raportet nga viti 2013 deri në vitin 2016 u audituan në vitin 2017. Raportet për 2018 dhe 2019 nuk janë audituar ende.

⁴⁰ Ligji parasheh që thirrja për emërimin e auditorëve si për financimet vjetore ashtu edhe për ato të fushatës në një vit të rregullt zgjedhor, të publikohet në janar dhe të përfundojë në mars.

⁴¹ Neni 19 i LFSP kërkon që KQZ të publikojë raportet vjetore financiare së bashku me raportet përfundimtare të auditimit deri më 30 qershor të çdo viti. Neni 43 i LZZP kërkon që KQZ të publikojë raportet e financimit të fushatës, pa përmendur konkluzionet e auditimit dhe nuk përcakton ndonjë afat.

⁴² KQZ-ja publikoi raportet financiare nga viti 2013 deri në 2017, me raportet e auditimit, në qershor 2019. Gjithashtu publikoi raportet vjetore dhe të financimit të fushatës së vitit 2019 të pa audituara në 2020.

⁴³ Paragrafi 215 i Udhëzimeve 2010 ODIHR dhe të Komisionit të Venecias për Rregulloren e partive politike thotë se “Parregullsitë në raportimet financiare [...] duhet të rezultojnë në humbjen e plotë apo të një pjese të fondeve të tilla për partinë. Sanksionet e tjera në dispozicion mund të përfshijnë pagesën e gjobave administrative nga partia.” Neni 16 i Rezolutës (2003)4 të Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi Rregullat e Përbashkëta kundër Korrupsionit në Financimin e Partive Politike dhe fushatave elektorale parasheh që “Shtetet duhet të kërkojnë që shkeljet e rregullave në lidhje me financimin e partive politike dhe fushatave elektorale t’i nënshtrohet sanksioneve efektive, proporcionale dhe dekurajuese.”

X. MEDIAT

Mediat dinamike tradicionale dhe në internet u siguruan votuesve qasje në pikëpamje të ndryshme politike; nevojitet më shumë përgjegjësi dhe transparencë në internet

Fushëveprimi Mediatik

Sektori i mediave në Kosovë është i larmishëm me një numër relativisht të lartë të mediave transmetuese.⁴⁴ Transmetuesi publik i Radio Televizionit të Kosovës (RTK), duke operuar katër kanale TV dhe dy radio stacione, konkurron për audiencën me shumë kanale televizive private të arritshme përmes operatorëve kabllorë në të gjithë Kosovën.⁴⁵ Televizioni mbetet burimi kryesor i lajmeve rreth politikës, i ndjekur nga portalet online dhe mediat sociale; këto të fundit shërbejnë gjithashtu si platforma për kanalet televizive për të transmetuar përmbajtjen dhe për të zgjeruar audiencën. Ekziston mundësia që interneti është platforma kryesore për kosovarët për t'iu qasur informatave në ditët e sotme.⁴⁶

Mungon hulumtimi sistematik i tregut ose audiencës (i një tregu relativisht të vogël të mediave në Kosovë) që do të lehtësonte zhvillimin më të qëndrueshëm të mediave bazuar në treguesit e tregut. Raporti vjetor i Komisionit të BE-së 2020 theksoi se: “*mungesa e vetëqëndrueshmërisë financiare i lë mediat të cenueshme ndaj interesave politike dhe të biznesit. Kjo përforcohet më tej nga mungesa e informatave dhe të dhënave mbi përfituesin përfundimtar të pronësisë së mediave...*”⁴⁷ Edhe RTK mbetet e ndjeshme ndaj ndikimit politik për shkak të mungesës së pavarësisë editoriale dhe financiare nga autoritetet;⁴⁸ MVZ-ja e BE-së 2019, rekomandoi trajtimin e kësaj çështjeje.⁴⁹

Në përgjithësi, në krahasim me fqinjët e saj në rajon, mediat në Kosovë gëzojnë një shkallë pak më të lartë të lirisë; Bashkëbiseduesit e MEZ BE nga sektori i medias informuan misionin se ata ishin në gjendje të ushtronin profesionin e tyre lirshëm në periudhën parazgjedhore. Megjithatë, sipas Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës, kishte kërcënime dhe sulme të drejtuara ndaj gazetarëve dhe mediave për disa vite, rreth 20 ose më shumë raste të tilla ndodhin çdo vit në Kosovë.⁵⁰

⁴⁴ Sipas Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), organi rregullator për mediat transmetuese, ka 111 kanale televizive dhe 89 radio stacione.

⁴⁵ Kanalet kryesore televizive private në Kosovë janë Kohavision (KTV), RTV21 (të dy kanale televizive me licencë për transmetim kombëtar), Channel 10, Klan Kosova, T7 dhe TV Dukagjini. Një kanal i ri privat televiziv, ATV, filloi të funksionojë në TV tregun tashmë të ngopur të Kosovës në prag të fushatës. Disa media në gjuhën serbe veprojnë në Kosovë, përfshirë kanalin televiziv publik RTK2.

⁴⁶ Numri i shikimeve të programeve televizive të transmetuara në mediat sociale është një tregues i popullaritetit të kanaleve televizive në Kosovë, pasi ka mungesë të hulumtimeve sistematike të audiencës.

⁴⁷ Për më shumë detaje shih raportin vjetor të Komisionit të BE-së 2020.

⁴⁸ Buxheti i RTK-së aktualisht përcaktohet çdo vit nga Kuvendi i Kosovës; Drejtori i RTK-së informoi MEZ BE se fondet e alokuara për transmetuesin publik nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar aktivitetet e rregullta të RTK-së. Sistemi i qëndrueshëm dhe i pavarur i financimit nuk është vendosur dhe procedurat e emërimit të anëtarëve të organeve drejtuese të RTK-së nuk janë transparente. Një rishikim i Ligjit për RTK filloi në 2019 por asnjë ndryshim nuk u miratua deri më tani.

⁴⁹ MEZ BE Kosovë 2019 raporti përfundimtar: rekomandimi nr. 22: ‘Çka duhet të merret parasysh për të forcuar pavarësinë e transmetuesit publik nga ndërhyrjet e mundshme politike është rishikimi i procesit zgjedhor të bordit të tij si dhe sistemi i tij i financimit.’

⁵⁰ Rasti më i rëndë i raportuar në 2021 deri më tani u shfaq menjëherë pas zgjedhjeve: më 24 shkurt tre persona me maska sulmuan dhe lënduan para banesës së tij Visar Duriqin, një gazetar hulumtues nga gazeta e internetit

Korniza ligjore dhe rregullative

Liria e shprehjes, si dhe liria dhe pluralizmi i mediave janë të integruara në Kushtetutë. Censura është e ndaluar, si dhe shpifja nuk është vepër penale. Korniza ligjore që rregullon mbulimin mediatik të zgjedhjeve, i rregulluar kryesisht nga LZP, mbetet parimisht i pandryshuar nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2017.⁵¹ Media transmetuese duhet të sigurojë një mbulim të drejtë dhe të barabartë të lajmeve (si dhe një qasje të drejtë dhe të barabartë në programet dhe debatet politike) për të gjitha subjektet e certifikuar politike. Nëse ata ofrojnë kohë transmetimi të paguar për kandidatët, ata janë të detyruar të sigurojnë gjithashtu një sasi minimale të kohës së transmetimit falas për të gjitha subjektet garuese. Përmbajtja me pagesë lejohet vetëm gjatë periudhës së fushatës. Përderisa legjislacioni i medias përcakton kufijtë në sasinë totale të reklamave të paguara në orë/ditë, *de facto* nuk ka asnjë kufizim në sasinë e kohës së transmetimit (e cila është një kategori me pagesë e veçantë e përmbajtjes) të paguar (të sponsorizuar). MVZ-të e dërguar nga BE-ja për zgjedhjet e mëparshme rekomanduan të rregullohet blerja e kohës së transmetimit në media transmetuese nga subjektet politike dhe të vendosen kufij në sasinë e kohës së paguar të transmetimit që media mund të shesë gjatë një fushate zgjedhore.⁵²

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), organi rregullator i mediave transmetuese, mbikëqyr pajtueshmërinë e transmetuesve me kornizën ligjore. KPM informoi MEZ BE se gjatë zgjedhjeve 2021, pavarësisht kornizës ligjore të pandryshuar, u përpoq të akomodonte disa rekomandime të mëparshme të MVZ BE. Së pari, KPM-ja filloi monitorimin e saj mediatik të mediave kryesore të transmetimit tashmë pesë ditë para periudhës zyrtare të fushatës (në zgjedhjet e mëparshme monitorimi i mediave i KPM-së u krye vetëm gjatë periudhës zyrtare të fushatës); Së dyti, KPM-ja u përpoq të zgjidhte parregullsitë e mundshme në një mënyrë më të shpejtë, kështu që nëse identifikohen shkeljet, KPM-ja do të rishikonte dhe analizonte raste të tilla dhe më pas të vendoste sanksione tashmë gjatë periudhës së shkurtër të fushatës.⁵³

KPM identifikoi disa shkelje bazuar në gjetjet gjatë detyrës së saj të monitorimit të mediave dhe pesë ditë para ditës së zgjedhjeve mbajti një seancë publike për të vendosur mbi ato raste; kjo rezultoi në disa gjopa (që ndryshuan nga 1,000 deri në 7,500 euro) të shqiptuara për të gjitha kanalet kryesore televizive. Shkeljet kishin të bënin me programe të sponsorizuara që disa herë nuk ishin shënuar qartë si të paguara (dhe nga cilët kandidat politik) dhe për reklama në ekran të

Insajderi. Policia filloi një hetim, por autorët e krimit mbeten të paidentifikuar. Shoqata e Gazetarëve të Serbisë (UNS) njoftoi se ekipi mediatik i Televizionit Rajonal Serb Kraljevo (RTV KV) nuk u lejua të hynte në Kosovë më 14 shkurt, ditën e zgjedhjeve.

⁵¹ Shtesat e të fundit në kornizën e legjislacionin/rregullimit mediatik përfshijnë Kodin e Etikës 2016 dhe Rregulloren e vitit 2017 për Ofruesit e Shërbimeve të Mediave Audio dhe Audiovizuale të aprovuara nga KPM-ja.

⁵² MEZ BE Kosovë 2019 raporti përfundimtar: rekomandimi nr. 20 (rekomandimi prioritar): '*Konsideratë ti jepet rregullimit të mëtejshëm të blerjes të kohës së transmetimit në mediat transmetuese nga subjektet politike. Kjo duhet të synojë të sigurojë kushte të barabarta dhe jo-diskriminuese për qasje në të, deklarimit publik të listave të çmimeve, si dhe të vendosë një kufi në sasinë e kohës së transmetimit që një transmetues mund t'i shesë secilit subjekt politik gjatë fushatës zgjedhore.*'


⁵³ MEZ BE Kosovë 2019 raporti përfundimtar: rekomandimi nr. 21: '*Procesi i vendimmarrjes së KPM-së duhet të rishikohet në mënyrë që të trajtojë shkeljet dhe ankesat në kohën e duhur, veçanërisht gjatë fushatës zgjedhore, dhe të zbatojë sanksionet dekurajuese*' dhe rekomandimin nr. 23: '*KPM-ja të forcojë mbikëqyrjen e rregulloreve ekzistuese të mediave për të siguruar që transmetuesit të sigurojnë një mbulim të baraspeshuar dhe të mos transmetojnë përmbajtje politike me pagesë jashtë periudhës së fushatës zgjedhore.*'

ndarë-shtesë (bashkimi i programeve të rregullta me reklama të paguara politike si një shirit në ekran) gjatë programeve për tema aktuale. Këto lloje të shkeljeve janë gjetur nga KPM-ja edhe gjatë zgjedhjeve të mëparshme legislative.⁵⁴ Pas shqiptimit të sanksioneve, KPM informoi misionin se disa transmetues kishin filluar t'i binden rregullores dhe filluan të shënonin reklamat e paguara siç kërkohej. KPM pohoi se për shkak të natyrës së shkeljeve në lidhje me kohën e transmetimit të paguar/sponsorizuar, e cila mund të identifikohet shpejt, ishte e mundur të jepeshin sanksionet brenda një afati kohor prej disa ditësh pasi rastet ishin identifikuar, por çështjet më komplekse do të kërkonin analiza më të hollësishme, si dhe rritjen e kapacitetit si dhe të kohës.


Mbulimi Mediatik i Zgjedhjeve

Gjatë periudhës zyrtare të fushatës, mediat kanë ofruar mbulimin e aktiviteteve të fushatës së partive (kryesisht tubimet me votuesit) në segmentet speciale në programet e lajmeve në mbrëmje dhe organizuan debate të shumta. RTK-ja ofroi një sasi të konsiderueshme të kohës së transmetimit falas dhe duket se ofronte mbulim të kandidatëve në një mënyrë të drejtë (siç kërkohej me ligj) në programe të ndryshme duke përfshirë debate dhe intervista me kandidatë kryesorë. Megjithatë, analizat nga MEZ BE të artikujve të RTK-së të postuara në faqen e tyre të internetit (dhe të shpërndara në faqen e tyre në Facebook) treguan animin e RTK-së ndaj disa subjekteve garuese.⁵⁵

ARTIKUJ TË RTK: WEBFAQET, FACEBOOK, KONTEKSTI NEGATIV



ARTIKUJ TË RTK: WEBFAQET, FACEBOOK, KONTEKSTI NEGATIV



Një tipar i veçantë i përmbajtjes së medias transmetuese është një rritje e diskutimeve ose debateve televizive të transmetuara nga të gjitha kanalet kryesore televizive në baza ditore. Përderisa ato rrisin shumëllojshmërinë e pikëpamjeve të disponueshme për votuesit përmes mediave, shumë bashkëbisedues të MEZ BE ishin kritikë ndaj cilësisë së programeve dhe ankoheshin për mungesën e diskutimeve rreth çështjeve thelbësore me të cilat përballemi në 'përditshmëri'. Temat e diskutuara në periudhën para fushatës përfshinin perspektivat e kandidatëve politikë me fokus në sondazhet e opinioneve (duke qenë LVV në avantazh), ndikimin e mundshëm të votave jashtë Kosovës dhe masat e lidhura me COVID-19. Gjatë periudhës së fushatës, TV Kanalet kryesore po organizonin debate si programe më kryesore të mbrëmjes, së bashku me programet kryesore të

⁵⁴ Në vitin 2021 KPM vendosi një shumë totale gjobash prej 36,500 euro, si krahasim, në 2019 shuma totale e gjobave ishte 24,000 euro.

⁵⁵ Ueb faqja e RTK-së postoi numrin më të madh të artikujve kushtuar LDK-së dhe PDK-së. Postimet e lidhura me LVV ishin më të pakta, dhe në krahasim me partitë e tjera portretizimi i të cilave ishte kryesisht neutrale, ndonjëherë portretizimi i LVV ishte negativ.

lajmeve. Shumica e debateve dhe diskutimeve përfshinë kandidatët, zakonisht përfaqësues të 2-3 partive të ndryshme, ose një përfaqësues të një subjekti garues në studio me analistë të ndryshëm. Nuk pati asnjë debat në mes të udhëheqësve kryesorë të partive kryesore, ose kandidatëve të tyre për Kryeministër, pavarësisht disa përpjekjeve nga media për ta organizuar atë.⁵⁶

Shoqëria civile zhvilloi një aktivitet të monitorimit të mediave, duke u përqendruar në diskutimet në shtatë kanale kryesore televizive gjatë periudhës para fushatës, si dhe gjatë fushatës zyrtare, ku gjithashtu u analizuan programet në lidhje me zgjedhjet.⁵⁷

Mediat Sociale dhe të Drejtat Digjitale

Internetit në Kosovë ka depërtuar shumë thellë; rreth 90 përqind të popullsisë janë përdorues të internetit.⁵⁸ Rreth 60 përqind e kosovarëve përdorin media sociale, kryesisht Facebook.⁵⁹ Përderisa Instagrami është gjithashtu i popullarizuar, Facebook është makina më e rëndësishme e përdorur nga subjektet politike për të komunikuar në internet me mbështetësit e tyre ose votuesit potencial, dhe përdoret gjithashtu nga institucionet, përfshirë qeverinë, si një platformë kryesore për të shkëmbyer informata. Twitter përdoret nga elitat politike kryesisht për të komunikuar mesazhe me një audiencë ndërkombëtare.

Nuk ka asnjë dispozitë në lidhje me zhvillimin e fushatës në media online ose në rrjetet sociale; Kosova nuk ka ndonjë legjislacion ose rregullore specifike që trajton dezinformimin, përtej ligjeve standarde të shpifjes. Meqenëse legjislacioni zgjedhor mbetet kryesisht i pandryshuar për më shumë se një dekadë, ai nuk trajton çështje që lidhen me zhvillimet përkatëse, siç janë rritja e rëndësisë së komunikimit digjital në fushatën zgjedhore ose nevoja për mbrojtje më të fuqishme të të dhënave personale dhe privatësisë së qytetarëve.

Mbrojtja e të dhënave personale është e garantuar në Kushtetutë dhe rregullohet kryesisht nga Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale (LMDhP) që u miratua në 2010 dhe u ndryshua në mënyrë thelbësore në 2019 për t'u harmonizuar me Rregulloren e përgjithshme të mbrojtjes së të dhënave (RPMdh) të miratuar në vitin 2016 në BE. Organi përgjegjës për privatësinë e të dhënave pas ndryshimeve të vitit 2019 është Agjencia për Informim dhe Privatësi e të Dhënave Personale (Agjencia), së cilës iu dha një mandat dhe kompetenca më të fuqishme në 2019. Megjithatë, për shkak të dështimit të Kuvendit për të emëruar Komisionerin e Agjencisë, autoriteti kryesor i Agjencisë, organi është vetëm gjysmë funksional, i mungojnë aktet nënligjore dhe dështon në kryerjen e detyrave të saj siç parashikohet me ligj, duke përfshirë

⁵⁶ Më 14 janar, Albin Kurti iu përgjigj një gazetari kur u pyet në lidhje me pjesëmarrjen në debate me udhëheqësit e tjerë: "Është e vërtetë që në Kosovë ekziston një konkurrencë e ashpër në mes të dy partive të vjetra. Kjo garë është për vendin e dytë. Në atë garë, as unë, as Presidenti nuk kemi çfarë të kërkojmë ose të bëjmë".

⁵⁷ Debatet televizive në kohë kryesore transmetuese (prime time) janë monitoruar nga Demokracia në Veprim (DiA) në kanalet televizive vijuese: RTK, KTV, RTV21, KLAN Kosova, T7, TV Dukagjini, Kanal 10. Një total prej 226 debate u monitoruan nga 13 janari deri 4 shkurti, duke përfshirë përfaqësuesit e subjekteve politike si më poshtë: 83 ishin nga PDK, 89 ishin nga LDK, 62 nga AAK, 55 nga LVV, 35 nga NISMA dhe 11 nga partitë jo-shumicë. Asnjë kandidat nga SL nuk mori pjesë në këto organizime.

⁵⁸ Statistikat botërore të internetit (Internet worlds stats) regjistruan një numër të përgjithshëm të përdoruesve të internetit në 2019 prej 1,693,942 përdorues. Burime të tjera vlerësojnë gjithsej 1,600, 000 përdorues në fund të vitit 2020, duke sugjeruar një rënie të lehtë ndoshta për shkak të migrimit të popullatës së re të kosovarëve.

⁵⁹ DataReportal 2020 raporti për Kosovën.

inspektimet e rregullta të institucioneve shtetërore për pajtueshmërinë e tyre me LMDhP. Kjo fazë ka zgjatur tashmë për katër vjet pasi tashmë paraardhësi i Agjencisë nuk ishte plotësisht funksional gjatë viteve të fundit të ekzistencës së saj. Duke pasur parasysh këto rrethana, LMDhP, që kur hyri në fuqi në 2019, akoma nuk është testuar plotësisht në praktikë.

Në disa faza të procesit, të dhënat personale dhe privatësia e qytetarëve nuk ishin të mbrojtura sa duhet. Rastet e përmendura nga misioni përfshinin publikimin e listave të votuesve (përfshirë jashtë Kosovës) nga KQZ-ja me detajet personale (emri, mbiemri, data e lindjes),⁶⁰ dhe raste të SMS-ve të pakërkua që nxisin qytetarët të votojnë për një parti politike që u dërguan te votuesit në ditën e zgjedhjeve pa pëlqimin paraprak dhe në shkelje të heshtjes zgjedhore. Rregullorja e LQP-së dhe e KQZ-së nuk janë në përputhje me LMDhP; përfaqësuesit e Agjencisë informuan misionin se ata i dërguan një këshillë KQZ-së, si dhe partive politike se si të respektojnë LMDhP-në kur merren me të dhënat private të qytetarëve, megjithatë, ndërhyrjet e tyre më të drejtpërdrejta nuk ishin të mundshme për shkak të mungesës së personit në postin e Komisionerit të Agjencisë. Pak para ditës së zgjedhjeve LVP pretendoi në MEZ BE se ka disa prova që sugjerojnë se të dhënat personale të votuesve që banojnë në Austri të cilët aplikuan për votim jashtë Kosovës në KQZ (përfshirë kopjet e dokumenteve të tyre të identitetit) ishin zbuluar dhe mund të keqpërdoren për identifikim të rremë dhe votim të paligjshëm në emër të tjetrit jashtë Kosovës, nga Austria. Kjo parti informoi MEZ BE që ata tashmë i kanë paraqitë informatat dhe provat te prokurori.

Rekomandimi: Të harmonizohet legjislacioni zgjedhor dhe rregulloret e KQZ-së me LMDhP për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve për privatësinë e të dhënave të tyre personale që përdoren në procesin zgjedhor.

Përmbytjet Mashtrore Online

Në mars të vitit 2020 Facebook hoqi 212 faqe, grupe dhe llogari në Facebook dhe Instagram për shkak të përfshirjes në sjellje mashtrore të koordinuar, që u krijuan në Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë, duke shpërndarë përmbytje të përgjithshme jo-kosovare.⁶¹ Një studim së fundi nga Parlamenti Evropian që vlerëson dezinformimin në Ballkanin Perëndimor zbuloi se politika në Kosovë është jashtëzakonisht e ndikueshme ndaj lajmeve dhe dezinformimit nga jashtë.⁶² Një numër masiv i dezinformimit po përhapej në Kosovë (si dhe në rajon) në vitin 2020 në kontekstin e pandemisë COVID-19, siç raportohet nga disa grupe të kontrollimit të

⁶⁰ Neni i LQP 7.2: Të gjithë votuesit me të drejtë vote, të shënuar në mënyrë të kërkuar nga KQZ-ja. Informatat personale të ofruara për secilin votues janë: emri, mbiemri, data e lindjes, adresa dhe Qendra e Votimit ku ai/ajo është caktuar për të votuar. 7.4 Lista e Votuesve është në dispozicion për të pasur qasje në të ashtu siç parashihet me rregullat e KQZ-së. Rregullorja e KQZ-së Nr. 02/2013, neni 3.7 përcakton tërësinë e të dhënave të publikuara si për listën përfundimtare të votuesve të Kosovës ashtu edhe për listën e votuesve jashtë Kosovës, që përmban emrin, mbiemrin dhe datën e lindjes.

⁶¹ 'Individët që qëndrojnë pas këtij aktiviteti vepruan me llogari të rreme për të administruar faqe që shpërndajnë përmbytje të përgjithshme, jo specifike për vendet si astrologjia, personazhet e famshëm dhe këshillat e bukuri.' Rreth 685,000 llogari ndoqën një ose më shumë nga këto faqe sipas raportit të Facebook.

⁶² Hartimi i lajmeve të rreme dhe dezinformimit në Ballkanin Perëndimor dhe identifikimi i mënyrave për t'iu kundërvënë në mënyrë efektive.

fakteve në Kosovë të takuara nga MEZ BE.⁶³ Ekspertët vendor sugjeruan që akterët politikë shpesh përdorin portalet e lajmeve si faqe dezinformimi dhe shpesh gjenerojnë dezinformata në përpjekje për të arritur përfitime politike afatshkurtra dhe për të lëkundur elektoratin.⁶⁴

Disa parti politike u ankuan në MEZ BE për një larmi lajmesh të rreme që po përhapen në hapësirën digjitale dhe disa akterë pretenduan se në të kaluarën ata ishin shënjestruar në mediat sociale nga mbështetësit e kundërshtarëve politikë. MEZ BE ka analizuar komentet në lidhje me postimet më të njohura të partive kryesore politike dhe komentet gjatë diskutimeve televizive të shpërndara përmes Facebook gjatë periudhës së fushatës.⁶⁵ Misioni gjeti një numër relativisht të vogël të komenteve negative dhe vetëm shumë pak llogari të dyshimta (jo të vërteta) të përfshira në biseda.⁶⁶ Kishte disa raste të fushatave negative, ndoshta të orkestruara, që synuan disa zëra kritikë.⁶⁷

Faqet në Kosovë përhapin lajme nga ueb faqe të ndryshme me tituj për klikime, për të tërhequr vizitorin e faqes në internet ose përdoruesin e Facebook për të klikuar në vegëzat. Përmbajtja e artikujve zakonisht është origjinale dhe shpesh botohet nga media të besueshme në Kosovë, por shpesh paraqitet me etiketime dhe tituj për klikime (clickbait); në disa raste, artikujt janë mashtrues, si në rastin e një sondazhi të opinionit në internet që pretendohet të jetë organizuar nga KQZ.⁶⁸ Rastet e lajmeve që janë qartësisht të rrejshme në disa raste përfundojnë në burime

⁶³ Në periudhën parazgjedhore, iniciativat aktive për verifikimin e fakteve ishin të pakta. Facebook nuk ka një organizatë partnere zyrtare të besuar për të ndihmuar në verifikimin e përmbajtjes me urrejtje.

⁶⁴ DISICON i NDI 2019, dezinformimi në Kosovë [gjetjet](#).

⁶⁵ Analiza e kryer në mediat sociale dhe komunikimi brenda Facebook, ka përfshirë faqet zyrtare të partisë, kandidatët zyrtarë për Kryeministër dhe udhëheqësit e partive, media, si dhe disa individë që u konsideruan më me ndikim në skenën politike. Faqet e monitoruara përbëheshin nga gjithsej 6 faqe zyrtare të partive, 24 faqe zyrtare të kandidatëve (kandidatë për Kryeministër dhe deputetë), 6 faqe të organizatave të lidhura me zgjedhjet, 6 analistë politikë, 8 stacione televizive dhe rreth 20 portale dhe media online. Kishte gjithashtu rreth 5 portale të lajmeve që kontrolloheshin periodikisht për prani të lajmeve mashtruese, sa i përket pranisë së përmbajtjes lidhur me zgjedhjet, si dhe 5 grupe me nivele të ndryshme të aktivitetit që ishin monitoruar para, si dhe gjatë fushatës.

⁶⁶ Janë analizuar gjithsej 10 nga 25 postimet me më shumë bashkëveprime në faqet e partive politike dhe kandidatët, ku pjesëve të komenteve iu dha një kontroll i plotë për komente negative, anti-fushatë, debate të mundshme dhe diskutime në mes të njerëzve, si dhe për llogaritë e rrejshme. Numri i komenteve në këto postime ndryshon në mes të 200 dhe 10,000, ku nga rreth 20 përqind e mostrës së komenteve të kontrolluara (që përfshinin komente që u pëlqyen më së shumti, dhe iu përgjigjën, ndër të tjera) kishte një numër të vogël të llogarive të rrejshme si dhe një numër i vogël i llogarive të dyshimta që nuk mund të identifikoheshin plotësisht si të rreme, por megjithatë shpesh shiheshin duke komentuar. Përmbajtja e komenteve të monitoruara ishte kryesisht në mbështetje të partisë ose kandidatit ku ajo shfaqej, me vetëm një numër të vogël të komenteve negative që morën shumë pak përgjigje. Prandaj, asnjë diskutim apo debat madhor nuk ishte i pranishëm në faqet zyrtare.

⁶⁷ Ka pasur një rast specifik të një analisti/ndikuesi politik i cili poston kryesisht përmbajtje kritike ndaj LVV, i cili duket se shpesh është viktimë e mospëlqimeve nga llogaritë që duken të rreme, kryesisht me origjinë nga vendet e huaja (llogari me emra të huaj që kanë pak ose aspak përmbajtje në faqet sugjeruan gjasat e një fushate të orkestruar negative.), për të cilën ai pretendoj se vjen nga LVV dhe mbështetësit e saj.

⁶⁸ Sondazhi i opinionit që supozohej se u organizua nga KQZ-ja ishte një artikull për klikime i ndarë nga disa faqe në internet dhe faqet e krijuara kohëve të fundit, vendndodhja kryesore e vendit të menaxherëve të faqeve është Maqedonia e Veriut. Është postuar nga Lajme Online me mbi 40,000 ndjekës.

të njohura të lajmeve.⁶⁹ Tregime mashtruese që qarkullojnë në internet në lidhje me fushatën, të shënuara nga MEZ BE në periudhën parazgjedhore, përfshinë një sondazh të rremë të opinionit që sugjeron se PDK kryeson në sondazhe,⁷⁰ pretendime të rreme që sugjerojnë blerjen e votës,⁷¹ ose komente që i atribuohen në mënyrë të gabuar një diplomati amerikan.⁷² Gjatë periudhës së fushatës në mediat sociale dhe postimet në mediat në internet qarkulluan histori të rreme më shpesh të synuara drejt LVV-së.⁷³ Misioni shënoi reklama të paguara për akterët politikë,⁷⁴ të cilët u sponsorizuan nga faqet/portalet që paraqitën veten si portale lajmesh ose të informimit.⁷⁵

Rekomandimi: Të rishikohet legjislacioni zgjedhor në mënyrë që të pasqyrojë rëndësinë e rritur të aspekteve të komunikimit digjital në fushatën zgjedhore dhe në procesin zgjedhor në përgjithësi. Transparenca dhe përgjegjësia e fushatave online mund të promovohet duke krijuar arkiva të detyrueshme të reklamave në internet, duke siguruar kërkesa të hollësishme të raportimit për ata që paguan për materiale të sponsorizuara, si dhe për ata që morën pagesa.

⁶⁹ Një lajm i rremë i postuar në faqen Publikos në Facebook (me rreth 200,000 ndjekës) në 5 shkurt paraqiti një histori të rreme që thoshte se qeveria e Avdullah Hotit do t'i japë secilit qytetar 100 euro nëse LDK fiton. Historia tërhoqi mbi 260 komente në faqen Publikos në Facebook; u postua këtu dhe këtu.

⁷⁰ Një postim i pavërtetë që paraqet një sondazh opinionit që sugjeron se PDK ishte në epërsi kishte një shtrirje të madhe përmes një faqe në Facebook të quajtur Universal, e cila po tregonte se një kompani e paanshme Amerikane (FiveThirtyEight Polls) kishte nxjerrë rezultatet e një sondazhi “që nuk ishte manipuluar nga asnjë prej mediave të Kosovës”

⁷¹ Disa faqe në dukje të dyshimta kanë postuar një foto të ekranit të një bisede të pretenduar në mes të dy personave anonimë, ku njëri përpiket të bindë tjetrin të votojë për LVV dhe të dërgojë një foto si provë në këmbim të 100 eurove. Kjo është postuar nga Gazeta Prishtina.

⁷² Një portal i quajtur MitrovicaPress dhe disa të tjerë, postuan një artikull duke pretenduar se ambasadori amerikan William Walker tha se “Kurti dhe Osmani e kanë turpëruar shtetin e Kosovës duke vizituar Mitrovicën”.

⁷³ Rasti i videos së manipuluar në mënyrë të dukshme u shfaq një ditë pas vizitës së fushatës së Albin Kurtit në një fshat të populluar nga Boshnjakët e Kosovës afër Prizrenit më 6 shkurt. Një video me një zë në prapavijë nga një ngjarje tjetër u dërgua në mediat e Kosovës, ku shihej Kurti duke iu drejtuar një turme e cila bërtiste ‘Serbia, Serbia’. Në videon origjinale, turma brohoriste: ‘Kurti, Kurti’. Videoja u redaktua me logon e Transmetuesit Publik të Serbisë (RTS) me komente mashtruese që tregojnë se Albin Kurti vizitoi Shtërpçën/Šterpce të populluar kryesisht nga komuniteti Serb i Kosovës. Kjo video pretendohet se ishte dërguar në media të ndryshme në Kosovë nga një person i lidhur me PDK-në. Disa portale të lajmeve e postuan atë, dhe më vonë e larguan, ndërsa mbeti e postuar në disa portale më pak të njohura në internet.

⁷⁴ Facebook nuk i ka dhënë përparësi Kosovës sa i përket rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në reklamat politike ose luftimin e dezinformimit. “Biblioteka e reklamave në Facebook” punon në një mënyrë të kufizuar pa ndjekur detajet e reklamave politike, duke i munguar në funksionin e saj Raportues i Bibliotekës së Reklamave. Facebook gjithashtu nuk ka një organizatë partnere zyrtare të besuar për të ndihmuar në verifikimin e përmbajtjes me urrjetje.

⁷⁵ Portali ‘Gazeta Prishtinaa’ (që gjithashtu përmbante një sondazh të rremë të supozuar të bërë nga një kompani amerikane që vuri PDK-në në epërsi), lëshoi një reklamë më 6 shkurt duke përdorur një pamje të një postimi nga Albin Kurti, dhe duke pretenduar një sjellje të keqe nga LVV me mbishkrimin që thoshte “Shikoni vetë se si Vetëvendosje pranon vjedhjen.” Reklama të tjera me pagesë u postuan nga faqja në Facebook e quajtur: ‘Like nese je shqiptar’ (Pëlqe këtë faqe nëse je shqiptar) - me reklama të lansuara në fund të janarit me Albin Kurtin, Ibrahim Rugovën (ish-presidentin, themeluesin e LDK-së), si dhe logot e LDK-së dhe LVV-së në reklama të ndara. Në shkurt ata sponsorizuan reklama me Albin Kurti dhe Vjosa Osmani së bashku, një nga logot e PDK-së dhe një tjetër që tregon Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli me logon e UÇK-së.

XI. PJESËMARRJA E GRAVE/FEMRAVE

Rritja e dukshmërisë së disa kandidatëve gra, përkundër pjesëmarrjes në përgjithësi të kufizuar politike të grave për shkak të qëndrimeve të ngulitura patriarkale

Barazia gjinore është e vendosur në dispozita të ndryshme të Kushtetutës.⁷⁶ Në pajtim me standardet ndërkombëtare, LZZ përmban dispozita që sigurojnë një përfaqësim minimal të garantuar të grave në Kuvend.⁷⁷ Gjegjësisht, aty përshkruhet një kuotë gjinore prej 30 përqind në listat e kandidatëve, shtuar aty një kërkesë për vendosje.⁷⁸ Përveç kësaj, një kuotë prej 30 përqind është gjithashtu e zbatueshme për alokimin e ulëseve në Kuvend.⁷⁹ Megjithatë, Ligji i vitit 2015 për Barazinë Gjinore parashikon barazi absolute (50 përqind) përfshirë organet legjislative dhe ekzekutive dhe institucionet e tjera publike.⁸⁰ Organizatat e të drejtave të grave ishin të mendimit që kuota 50 për qind të ishte e zbatueshme për listat e kandidatëve dhe alokimin e ulëseve në Kuvend.⁸¹ Në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, as subjektet politike dhe as administrata e zgjedhjeve nuk miratoi ndonjë masë konfirmuese vullnetare për të rritur numrin e grave kandidatë dhe numrin e grave si anëtare të komisioneve zgjedhore.

Nga 1,052 kandidatë të certifikuar, 364 ishin gra, duke përfaqësuar 34,60 përqind e të gjithë kandidatëve, në përputhje me kuotën ligjore. Pozitivisht, kandidatët femra në listën e LVV arritën në 37.38 përqind, duke përfshirë pesë gra në mes të dhjetë kandidatëve të parë në listë. Në total, dy parti politike dhe dy iniciativa qytetare drejtoheshin nga gra që ishin në të njëjtën kohë bartëse të tre listave të kandidatëve.⁸² Znj. Osmani (nga LVV) ishte e vetmja grua kandidatë e nominuar për presidente.

⁷⁶ Shih nenet 71.2, 101.1, 104.2, 108.2, 110.1 dhe 114.1 të Kushtetutës.

⁷⁷ Shih nenin 4.1, CEDAW dhe paragrafin 20 të Rekomandimit të Përgjithshëm nr. 25 për nenin 4.1 të CEDAW. Pjesa 2.5 e Kodit të Komisionit të Venecias i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore deklaron se: “Rregullat ligjore, të cilat kërkojnë një përqindje minimale të personave të secilës gjini në numrin e përgjithshëm të kandidatëve, nuk duhen konsideruar si shkelje të parimit për votim të barabartë, nëqoftëse kanë një bazë kushtetuese.”

⁷⁸ Duhet të ketë të paktën një kandidat nga secila gjini në mes të çdo tre kandidatëve në një listë.

⁷⁹ Në terma praktikë, nëse kandidatët femra të një subjekti politik marrin më pak se 30 përqind të ulëseve të alokuara për atë subjekt, kandidati i fundit - me numrin e votave - mashkulli zëvendësohet nga numri i ardhshëm i votave - kandidatja femër deri sa numri i përgjithshëm i ulëseve të alokuara për kandidatet femra arrijnë në 30 përqind.

⁸⁰ Neni 6.7 dhe 8 i Ligjit 2015 për Barazinë Gjinore përcaktojnë: “Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.”

⁸¹ Para zgjedhjeve të vitit 2019, Avokati i Popullit i atëhershëm kishte deklaruar se Ligji për Barazinë Gjinore si *lex posterioris* dhe *lex specialis* zëvendësoi Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ai gjithashtu kishte paraqitur një ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër KQZ-së për diskriminim gjinor në listat e kandidatëve dhe kërkoi masa të përkohshme që kërkojnë nga KQZ-ja të zbatojë një kuotë prej 50 përqind në listat e kandidatëve. Gjykata hodhi poshtë kërkesën për masa të përkohshme, me arsyetimin se një urdhër i tillë do të paragjykonte aktgjykimin mbi kërkesën kryesore, i cili ishte identik. Padia kryesore është ende në pritje të gjykatës.

⁸² Përkatesisht, SDU e udhëhequr nga Duda Balje, NDS e udhëhequr nga Emilija Redžepi, UZ-AH Komuniteti i Bashkuar i udhëhequr nga Adrijana Hodžić, “Guxo” e udhëhequr nga Vjosa Osmani dhe Alternativa e udhëhequr nga Mimoza Kusari (dy të fundit në listën e LVV).

Sipas bashkëbiseduesve të MEZ BE, krahasuar me zgjedhjet e kaluara, ishte rritur dukshmëria e disa grave kandidate në fushatë, veçanërisht e kandidates së LVV, Znj Osmani, e cila ishte gjithashtu ushtruese e detyrës së Presidentes së Kosovës gjatë periudhës së fushatës. OJQ-ja Rrjeti i Grave të Kosovës zhvilloi një fushatë online për të inkurajuar votuesit të votojnë për kandidatet femra, pavarësisht nga pikëpamjet politike. Disa bashkëbisedues të MEZ BE deklaruan se gratë përballen me pengesa sociale dhe familjare për t'u propozuar për pozitë të zgjedhur ose për të bërë fushatë të suksesshme dhe kështu nuk po shërbejnë si udhëheqëse dhe vendimmarrëse, si rezultat i modeleve të ngulitura patriarkale.

Nuk ka kuota gjinore për përbërjen e komisioneve zgjedhore. Ashtu si në praktikën e kaluara, KQZ nuk publikoi asnjë informatë mbi përbërjen e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe Këshillave të Vendvotimeve (KVV), përfshirë statistikën gjinore. Vëzhguesit qytetarë raportuan se gratë përbënin rreth 30 përqind të anëtarëve të KVV-ve me një përqindje më të ulët si kryetare të KVV-ve. Kryetari i KQZ-së dhe një nga dhjetë anëtarët janë gra.

XII. PJESËMARRJA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE GRUPET E TJERA TË CENUESHME

Mungesë e masave për të mundësuar përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike si dhe votimin e pavarur (jo i asistuar)

Nga KQZ kërkohet me ligj t'ju sigurojë personave me nevojë të veçanta dhe rrethana të kufizuara (NVRr), përfshirë ata me aftësi të kufizuara (PAK), të jenë në gjendje të marrin pjesë në procesin zgjedhor.⁸³ Gjithsej 2,785 persona u regjistruan për NVRr votim; 1,348 në shtëpi dhe 1,511 të mbyllur në institucione. Ashtu si kërkohet me ligj, KKZ-të themeluan rreth 183 Ekipë Mobile KVV dhe Ekipë për Votuesit nëpër Institucione për të realizuar votimin në ditën e zgjedhjeve.

Sipas qytetarëve që ishin vëzhgues, rreth 40 përqind e vendvotimeve nuk ofruan votim për persona me aftësi të kufizuara pa asistencë, përfshirë qasjen e pavarur nga personat me aftësi të kufizuara fizike dhe udhëzuesit e votimit që lexohen me prekje për votuesit me probleme shikimi, të cilët më tepër varen nga votimi i asistuar. OSBE ofroi një trajnim të veçantë për të trajtuar shkrim-leximin relativisht të ulët të alfabetit Braille. Megjithatë, votuesit të cilët nuk mund të votojnë në një qendër të votimit, për shkak të aftësisë së kufizuar fizike, shëndetësore ose ndonjë lloj tjetër, mund të kërkonin votim në shtëpi. KQZ-ja vendosi 183 ekipe mobile të KVV-ve për të kryer votime në shtëpi. Gjysma e tyre ishin ekipe me pajisje të posaçme mbrojtëse për të kryer votimin në shtëpi të individëve të infektuar me COVID-19 ose të vetë-izoluar. Në përgjithësi, masat e vendosura nuk kanë paraparë integritet efektiv dhe votim të pavarur nga PAK, siç kërkohet nga standardet ndërkombëtare.

⁸³ Neni 99.1 i LZP kërkon që KQZ të krijojë "rregullat për votim për personat me nevojë të veçanta" për votuesit që nuk mund të votojnë në qendrat e votimit për shkak të paaftësisë fizike, shëndetësore ose paaftësisë tjetër, të atyre që janë të izoluar në kujdesin shëndetësor, institucionet sociale dhe korrigjuese dhe ata që nuk mund të votojnë në VV-të caktuar të tyre për shkak të zhvendosjes ose brengave që lidhen me siguri.

Ligji kërkon që fushatat e edukimit të votuesve të jenë gjithëpërfshirëse dhe gjithashtu të synojnë votuesit analfabetë. Përderisa KQZ-së i kërkohej me ligj të prodhojë informata për votuesit në gjuhën e shenjave,⁸⁴ informacioni për votuesit në faqen e internetit të KQZ-së nuk u ishte përshtatur personave me aftësi të kufizuara, duke rrezikuar mundësinë e tyre për të marrë informata lidhur me zgjedhjet mbi baza të barabarta.⁸⁵ Nuk ka kërkesa ligjore për media publike ose private që të përshtatin programet e tyre zgjedhore për PAK.⁸⁶

XIII. VËZHGIMI NGA SHOQËRIA CIVILE

Një rrjet i mirë-krijuar i organizatave të shoqërisë civile ishte përfshirë në aktivitetet e vëzhgimit në vend, i koordinuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), një degë e Transparencës Ndërkombëtare (Transparency International), nën patronatin e Demokracisë në Veprim (DiA). Rrjeti vendosi në pika rreth 500 vëzhgues për të vëzhguar se si po zhvillohet dita e zgjedhjeve. Ata gjithashtu angazhuan 16 vëzhgues afatgjatë për të monitoruar fushatën zgjedhore, përfshirë në disa komuna me shumicë serbe të Kosovës gjatë periudhës 10-ditore të fushatës. DiA gjithashtu ka analizuar mediat tradicionale dhe sociale, si dhe ka monitoruar pajtueshmërinë e subjekteve garuese me rregulloren në fuqi për financimin e fushatës.

XIV. KONTESTET ZGJEDHORE

Mangësitë në legjislacion dhe zbatimin e tij nga PZAP dhe gjykatat shpesh i lënë akterët pa korrigjim efektiv ligjor

Adresa kryesore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP).⁸⁷ Subjektet politike dhe kandidatët mund të paraqesin ankesa për parregullsi dhe për disa lloje të vendimeve të KQZ-së të shënuara në formë të listës së hollësishme në ligj. Votuesit mund të paraqesin ankesa nëse kanë interes juridik ose nëse u janë shkelur të drejtat, por kjo interpretohet ngushtë duke i privuar nga një mundësi, *ndër të tjera (inter alia)*, për të sfiduar certifikimin e kandidatit dhe rezultatet e zgjedhjeve, në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.⁸⁸ Vendimet e PZAP-it mund të apelojnë në Gjykatën Supreme vetëm nëse gjoba

⁸⁴ Një ueb faqe mbështetëse ndaj PAK mund të përdorë teknologji ndihmëse, të tilla si 'alt tag' që lexohen me zë për përdoruesit me dëmtim të shikimit, me hapësirë të zmadhuar për klikim për përdoruesit me probleme të lëvizjes, udhëzues të lexueshëm për audiencat e moshuara.

⁸⁵ Neni 21 i KDPAK kërko sigurimin e "informatave të destinuar për publikun e gjerë për personat me aftësi të kufizuara në formate të qasshme [...] të përshtatshme për lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara" dhe për të inkurajuar "mjetet e komunikimit masiv [...] t'i bëjnë shërbimet e tyre të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.

⁸⁶ Nenet 1.11 dhe 1.12 të Ligjit për Radio Televizionin përmban vetëm dispozita të përgjithshme siç është "vëmendje e veçantë i kushtohet personave me aftësi të kufizuara sa i përket programeve dhe ofritit të informatave".

⁸⁷ PZAP është një organ i përhershëm i pavarur, i përbërë nga dhjetë gjyqtarë të emëruar nga Kryetari i Gjykatës Supreme për një mandat katër vjeçar të rinovueshëm.

⁸⁸ Paragrafi 92 i Kodit të Komisionit të Venecias i Praktikës së Mirë deklaron se: "[...] Kjo ka të bëjë veçanërisht për rezultatet e zgjedhjeve: qytetarët mund t'i kundërshtojnë ato për parregullsi në procedurat e votimit. Apeli mund të zbatohet gjithashtu për vendimet e marra përpara zgjedhjeve, veçanërisht lidhur me të drejtën për të votuar, listat e zgjedhësve dhe e drejta për të vënë kandidaturën, vlefshmëria e kandidaturave, zbatimin i

e shqiptuar tejkalon 5,000 euro ose janë prekur të drejtat themelore, duke përjashtuar vendimet e tjera nga një rishikim gjyqësor, në kundërshtim me praktikën e mira.

Ankesat dhe parashtrirat duhet të paraqiten në PZAP dhe Gjykatën Supreme brenda 24 orëve nga vendimi i KQZ-së ose PZAP ose që kur shkelja ka ndodhur ose është bërë e ditur. PZAP dhe Gjykata Supreme duhet të vendosin brenda 72 orëve. Sipas ligjit, ankesat nga votuesit në Kosovë që ju mohua regjistrimi duhet të paraqiten në Njësinë Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë më së voni 40 ditë para ditës së zgjedhjeve, gjë që nuk është e mundur në rast të zgjedhjeve të parakohshme.⁸⁹ Aplikantëve të pasuksesshëm për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës u jepet gjithashtu 24 orë për t'u ankuar. Në disa raste, afati 24 orësh nuk lejoi kohë të mjaftueshme për përgatitjen dhe paraqitjen e ankesave, në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.⁹⁰

Përderisa shqyrtimet publike janë opsionale si për PZAP ashtu edhe për Gjykatën Supreme, shqyrtimi bazohet në parashtrime me shkrim nga palët dhe PZAP mund të vendosë të urdhërojë një hetim, nëse e gjykon të nevojshme.⁹¹ Në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare, PZAP ofroi një formular për të lehtësuar paraqitjen e ankesave dhe mban një regjistër ankesash i cili është i disponueshëm për publikun. Përderisa ligji kërkon që KQZ, PZAP dhe gjykatat të publikojnë vendimet e tyre, përfshirë ato ndaj ankesave, ai nuk përcakton një afat të shkurtër, gjë e cila nuk garanton publikimin me kohë.

PZAP mund të vendosë sanksione ndaj një subjekti politik për shkeljet e kryera nga kandidatët, anëtarët ose mbështetësit e atij subjekti. Sanksionet përfshijnë gjobë deri në 50,000 euro, heqje të së drejtës për të qenë anëtar i një komisioni zgjedhor deri në gjashtë vjet dhe revokim të akreditimit të një organizate vëzhguese ose një vëzhguesi. Në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe Kushtetutën, PZAP, organ ky administrativ e jo një gjykatë, mund të privojë një individ nga e drejta për t'u kandiduar dhe mund të de-certifikojë një subjekt politik.

Kontestet e ditës parazgjedhore

Në total janë paraqitur tetë ankesa në PZAP nga gjashtë subjekte politike kundër vendimeve të KQZ-së që mohonin certifikimin e listave të tyre të plota që përmbajnë kandidatë të dënuar;⁹² këto

rregullave të fushatës zgjedhore, mbulimi nga media dhe mundësia për të marrë financime për partitë" Paragrafi 99: "Të gjithë kandidatët dhe zgjedhësit e regjistruar në zonën përkatëse zgjedhore duhet të kenë të drejtën e ankimit. Në rastin e ankimit nga votuesit për rezultatet e zgjedhjeve mund të aplikohet një kuorum i arsyeshëm". Në *Davydov dhe të tjerët kundër Rusesë*, GJEDNJ deklaroi se "parregullsitë serioze në procesin e numërimit dhe tabelave të votave mund të përbëjnë një shkelje të së drejtës individuale për zgjedhje të lira të garantuara sipas Nenit 3 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, si në aspektet e saj aktive ashtu edhe në ato pasive."

⁸⁹ Gjithsej 131,230 votues të regjistruar me letërnjoftime të UNMIK-ut u larguan nga lista e votuesve. MEZ BE nuk është në dijeni nëse nga këta individë është paraqitur ndonjë ankesë.

⁹⁰ Shih paragrafin 95 të *Kodit të Komisionit të Venecias i Praktikës së Mirë*: "[...] Megjithatë, këto afate kohore duhet të zgjasin aq sa për të garantuar ushtrimin e së drejtës së apelit si dhe marrjen e një vendimi të peshuar mirë. Një afat kohor tri deri në pesë ditë në instancën e parë (duke përfshirë paraqitjen e apelit dhe marrjen e vendimit) duket se është i arsyeshëm për vendime që merren para zgjedhjeve."

⁹¹ Të zbatueshëm janë Ligji për procedurat administrative dhe rregullorja e punës së PZAP.

⁹² Ankesat u paraqitën nga LVV, AAK, NISMA, PDAK, PAI, PREBK.

ankesa u miratuan pjesërisht nga PZAP i cili vërtetoi listat pa kandidatët e dënuar.⁹³ Rrjedhimisht, pesë subjekte politike paraqitën ankesa në Gjykatën Supreme e cila mbështeti de-certifikimin e PZAP dhe KQZ të kandidatëve të dënuar, por edhe urdhëroi certifikimin e tre kandidatëve, periudha tre vjeçare e të cilëve do të përfundonte deri në ditën e zgjedhjeve pas dënimit të formës së prerë.⁹⁴ Gjykata Supreme nuk ishte dakord me de-certifikimin e kandidatëve të dënuar nga KQZ dhe PZAP, por deklaroi se nuk mund t'i hedh poshtë këto vendime për shkak të një vendimi të detyrueshëm të Gjykatës Kushtetuese.⁹⁵ Një ankesë shtesë u bë kundër certifikimit të një kandidati të një subjekti jo-shumicë (boshnjak të Kosovës); kandidati rrjedhimisht u de-certifikua nga PZAP dhe Gjykata Supreme me arsyetimin se ai ishte shqiptar me etnicitet më parë sesa boshnjak, megjithëse nuk ekziston një kërkesë e tillë ligjore dhe një vendim i tillë nuk është ligjërisht i drejtë.⁹⁶ Një ankesë tjetër e ngjashme u hodh poshtë për shkak të paraqitjes me vonesë.⁹⁷

PZAP-i nuk pranoi pranueshmërinë e disa ankesave me arsyetimin se vendimet e kundërshtuara të KQZ-së nuk janë të apelueshme me ligj, duke mohuar mjete juridike efektive për aspektet e rëndësishme të procesit zgjedhor.⁹⁸ Gjegjësisht, PZAP hodhi poshtë ankesat e paraqitura nga subjektet politike kundër vendimeve të KQZ-së që refuzojnë emërimin e të emëruarve të tyre si anëtarë të KKZ-së. Gjithashtu hodhi poshtë dy ankesa të paraqitura nga LVV dhe OJQ Germin që sfiduan ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e vendimit të KQZ-së për të verifikuar të drejtën e zgjedhësve aplikantë jashtë Kosovës përmes telefonatave.⁹⁹

Rekomandimi: Të përshkruhet që të gjitha vendimet e KQZ-së mund të kundërshtohen në PZAP dhe të gjitha vendimet e PZAP mund të apelojnë në gjykatë, pavarësisht nga shumica e gjorbës ose nëse preket një e drejtë themelore.

⁹³ Neni 122.3 kërkon që PZAP të drejtojë KQZ-në që të rishikojë vendimin e saj ose të marrë masa përmirësuese, por jo të ndryshojë vendimin e KQZ-së. Rrjedhimisht, KQZ-ja duhet të votojë përsëri për të vërtetuar listat pa kandidatët e dënuar. Prandaj, me ndryshimin e vendimit të KQZ-së, PZAP-i tejkaloi kompetencat e tij. Para vendimit të PZAP-it, Kryetari i KQZ-së kishte këshilluar PZAP-in që pjesërisht ti miratojë ankesat.

⁹⁴ Gjegjësisht, Liburn Aliu dhe Labinote Demi Murtezi nga LVV dhe Shemsedin Dreshaj nga AAK.

⁹⁵ Aktgjyrimi i Gjykatës Supreme i datës 29.01.2021 thotë se Kushtetuta dhe Kodi Penal kërkojnë një vendim gjykatë që privon të drejtën e kandidimit të individit të dënuar dhe se LKP është antikushtetuese dhe jo lex specialis për këtë çështje. Në vitin 2017, Gjykata Supreme kishte vendosur se neni 29 i LKP ishte antikushtetues, por vendimi i tij nuk ishte i detyrueshëm për rastet në të ardhmen, ndryshe nga një vendim i Gjykatës Kushtetuese.

⁹⁶ Partia Boshnjake e Kosovës SDU kërkoi de-certifikimin e Emin Neziraj, kandidatit të partisë Boshnjake të Kosovës “Nova Demokratska Stranka” (NDS) me arsyetimin se ai ishte shqiptar me etnicitet. Vendimi i PZAP për miratimin e ankesës u apelua nga NDS në Gjykatën Supreme, e cila vendosi që kandidati ishte vetëdeklaruar si shqiptar me etnicitet në Facebook dhe academia.com dhe hodhi poshtë provat bazuar në një dokument të lëshuar nga Zyra për Komunitete dhe të Kthyer që thoshte se Neziraj është boshnjak me etnicitet.

⁹⁷ Një ankesë e paraqitur nga Partia Liberale Egjiptiane (PLE) kundër certifikimit të kandidatit Sabina Berisha të Nismës Egjiptiane Demokratike të Re (IRDK), gjithashtu duke përmendur se ajo vetëdeklarohet si Rome në Facebook.

⁹⁸ Bazuar në nenin 63.6 të LKP, PZAP konsideron se neni 122.1 i LKP përmban një listë të detajuar të llojeve të apelueshme të vendimeve të KQZ-së.

⁹⁹ Ankuesit, LVV dhe OJQ Germin, pretenduan se verifikimi i pranueshmërisë me anë të thirrjeve telefonike është në kundërshtim me nenin 5 të LKP (përshtatshmëria e votuesve) dhe 22, 45, 53, 55 të Kushtetutës (heqjen e drejtës së votës në kundërshtim me Kushtetutën dhe detyrimet ndërkombëtare).

Aplikantëve të pasuksesshëm për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës iu mohua mjeti juridik efektiv, gjë e cila potencialisht rezultoi në heqjen e drejtës së votimit votuesve të kualifikuar.¹⁰⁰ Domethënë, PZAP kërkoi që aplikantët e pasuksesshëm jashtë Kosovës të paraqesin ankesat e tyre personalisht ose me postë dhe jo me email,¹⁰¹ gjë që është në kundërshtim me ligjin;¹⁰² dhe jo e realizueshme për shkak të kufizimeve kohore.¹⁰³ Bashkëbiseduesit e MEZ BE pretenduan se këto njoftime dekurajuan aplikantët jashtë Kosovës nga paraqitja e ankesave. Pavarësisht kësaj, më 2 shkurt, brenda afatit prej 24 orësh, mbi 1.000 ankesa u paraqitën me email në PZAP nga aplikantët e pasuksesshëm jashtë Kosovës. PZAP shqyrtoi vetëm 320, përderisa konsideroi të papranueshme rreth 750, me arsyetimin se ata nuk e kishin ankesën si shtojcë (bashkëngjitje), megjithëse kjo nuk kërkohet me ligj. Në kundërshtim me ligjin, PZAP nuk u kërkoi 750 ankuesve të korrigjonin mangësitë e pretenduara të ankesave të tyre.¹⁰⁴ Nga 320 ankesa të shqyrtuara, 146 u miratuan dhe votuesit u regjistruan, përderisa pjesa tjetër u refuzua për mungesë të informatave, pa u kërkuar aplikantëve të korrigjonin aplikacionet e tyre, siç kërkohet me ligj.¹⁰⁵

PZAP pranoi rreth 30 ankesa për shkelje të pretenduara të fushatës dhe miratoi më shumë se gjysmën e tyre. Shumica e ankesave u paraqitën nga organizata vëzhguese të shoqërisë civile si dhe disa nga subjektet politike. Për këto shkelje, në total u gjositën gjashtë subjekte politike. Gjegjësisht, AAK-34,900 euro; NISMA-20,000 euro, LDK-6,000 euro; PDK-23,000 euro, LVV-7,200 euro dhe SL-1,200 euro.¹⁰⁶ Në katër raste, PZAP vendosi gjoba për NISMA, AAK dhe PDK për nxitje të urrejtjes.¹⁰⁷ Përderisa NISMA dhe AAK u gjositën me 20,000 euro secila, PDK u gjosit me vetëm 2,000 dhe 8,000

¹⁰⁰ Një total prej 29,100 e aplikantëve jashtë Kosovës ju është refuzuar regjistrimi me arsyetimin se ata nuk kanë provuar identitetin e tyre, nuk i kanë plotësuar kriteret e zotësisë juridike ose nuk e kanë nënshkruar kërkesën për regjistrim.

¹⁰¹ PZAP deklaroi në faqen e saj të internetit që ankesat nga votuesit jashtë Kosovës duhet të parashtrohen vetëm personalisht ose me postë, ose në formularin që gjendet në faqen e internetit ose në një letër të bardhë.

¹⁰² Neni 74.5 i ligjit për Procedurën Administrative thotë: “Një kërkesë me shkrim, gjithashtu mund të parashtrohet me postë apo në mënyrë elektronike drejtpërdrejt në adresën zyrtare të organit të cilit i drejtohet. Nëse kërkesa e parashtruar nuk mund të lexohet, organi publik pa vonesë do të njoftojë dërguesin dhe do të kërkojë nga ai që të parashtrojë kërkesën në një formë tjetër më të përshtatshme.” Neni 77 thotë: “Dispozitat e këtij Ligji mbi formën, përmbajtjen dhe parashtrimin e kërkesës fillestare, do të zbatohen, përshtatshmërisht, për çdo aplikim, petition, propozim, ankesë, kundërshtim, deklaratë apo çdo lloj tjetër parashtrës, që palët i drejtojnë një organi publik.”

¹⁰³ Krahësuar me 17 ditë për zgjedhjet e vitit 2019, në 2021, aplikantët jashtë Kosovës kishin vetëm 10 ditë (2-12 shkurt) për të parashtruar ankesa, për të marrë një përgjigje dhe për të dërguar fletëvotimin e tyre.

¹⁰⁴ Shih nenin 74.5 të Ligjit për Procedurën Administrative më lartë.

¹⁰⁵ Shih paragrafin 96 të Kodit të Praktikës së Mirë: “Është e nevojshme të eliminohet formalizmi në mënyrë që shmangen rastet kur apelimet refuzohen për gabime në hartimin e tyre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për rastet me ndjeshmëri politike.”

¹⁰⁶ LDK - 4,000 euro për fushatë në Ministrinë e Bujqësisë dhe 2,000 për pengimin e fushatës së një subjekti tjetër politik; PDK - 2,000 euro për fushatë në një shkollë publike, 12,000 për postera në hapësira publike, 1,000 dhe 8,000 për nxitje të urrejtjes; LVV-1,200 euro për postera në shtylla elektrike dhe 6,000 për një tubim publik pa njoftim paraprak; SL - 1,200 euro për mbishkrime në ndërtesat publike; AAK-1,200 euro për postera në rrugët publike, 4,000 për fushatë në Ministrinë e Drejtësisë, 2,500 për ekspozimin e të miturve në fushatë, 3,000 për fushata në institucionet shëndetësore publike, 1,300 dhe 1,500 për posterat në ndërtesat publike, 1,400 për posterat në shtyllat elektrike dhe 20,000 për nxitje të urrejtjes.

¹⁰⁷ AAK kishte një video ku thuhej se Presidenti i Serbisë Vuçiq do të votojë për kandidaten e dobët znj. Vjosa Osmani; NISMA kishte një video ku thuhej se Z. Hoxhaj, kandidati i PDK për Kryeministër, në librin e tij të botuar në vitin 2017 mohoi gjenocidin të ketë ndodhur në Kosovë; një mbështetës i PDK-së në një postim në Facebook e quajti Albin Kurti një tradhtar.

euro. Në vend të ligjit, rregullorja e punës (rregullat dhe procedurat) së PZAP-it përshkruan sanksione, përfshirë gjobat, dhe i jep PZAP-it fuqinë e gjerë diskrete për të përcaktuar shumat e gjobave të vendosura.¹⁰⁸ NISMA dhe AAK u urdhëruan që menjëherë të tërheqin videon kundër zonjës Osmani (LVV) dhe z. Hoxhaj (PDK) nga media, përderisa një urdhër i tillë nuk iu dha PDK-së. Në bazë të ankesave, Gjykata Supreme la në fuqi gjobat e vendosura nga PZAP. Për më tepër, dispozita e LZP për nxitjen e urrejtjes është tepër e gjerë dhe është interpretuar dhe zbatuar gjerësisht për të sanksionuar retorikën negative ndaj kandidatëve individualë.¹⁰⁹

Kontestet pas ditës së zgjedhjeve

PZAP miratoi rreth 117 nga 148 ankesa për shkeljet e ditës së zgjedhjeve dhe gjobiti subjektet politike me 120,000 euro. Prej tyre rreth 50,000 euro ishin për shkelje të heshtjes zgjedhore, duke përfshirë atë me anë të SMS mesazheve që i nxisnin pranuesit të votonin për disa parti dhe postimet në rrjetet sociale. PDK u gjobit me 42,500 euro, LVV me 37,500 euro, LDK 22,000 euro, AAK 60,250, NISMA 2,000 euro dhe SL me 1,000 euro.

Pas një kërkesë nga LVV para ditës së zgjedhjeve, Prokurori filloi një hetim, pas ditës së zgjedhjeve, për të identifikuar identifikime të rreme të mundshme dhe votim të paligjshëm në emër të personit tjetër. Supozohet se LVV i ka paraqitur Prokurorit një video që përmban rreth 4,700 kopje të letërnjoftimeve të votuesve jashtë Kosovës të vjedhura nga KQZ dhe të transportuara me autobus për në Vjenë.¹¹⁰ Pretendohet që këto letërnjoftimet e përvetësuara u përdorën për dërgimin e fletëvotimeve postare në emër të votuesve jashtë Kosovës në Austri, gjë që do të rezultojë në votim të shumëfishtë dhe papranueshmëri të fletëvotimeve, potencialisht në kurriz të LVV-së që gëzon mbështetjen më të madhe në mesin e votuesve të diasporës.

Për shkak të mospërputhjeve të mëdha të identifikuar në protokollet e rezultateve (FRK-ve), KQZ urdhëroi rinumërimin e mbi 500 vendvotimeve. Bashkëbiseduesit e MEZ BE vunë në dukje se anëtarët e KVV shpesh ndërhyjnë në rezultatet për kandidatët, nën presionin e kandidatëve me ndikim.¹¹¹ Përderisa ka indikacione të falsifikimit të rezultateve të KVV nga anëtarët e KVV dhe disa kandidatë, asnjë hetim penal nuk ka filluar.¹¹²

Ligji parashikon ankesa për parregullsi gjatë votimit dhe numërimit dhe të rezultateve të qendrave të votimit, si dhe kundër numërimit në QNR.¹¹³ E drejta për të parashtruar ankesa kundër rezultateve të vendvotimit u jepen vetëm anëtarëve të KVV-ve të cilët kanë regjistruar një kundërshtim në librin e

¹⁰⁸ Neni 2.5 i Rregullores së Punës së PZAP kërkon që PZAP të marrë parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese, natyrën dhe seriozitetin e shkeljes dhe ndikimin e saj të mundshëm në procesin zgjedhor, përsëritjen e shkeljes dhe shumën e fondeve publike të marra nga subjekti politik.

¹⁰⁹ Shih nenin 141 të Kodit Penal, nenin 33.1.1 të LZP dhe 4.1.k të Rregullores së KQZ 11/2013.

¹¹⁰ Për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës, KQZ-ja punësoi rreth 300 punonjës të përkohshëm për të shtypur kopjet e letërnjoftimeve të dërguara me email nga aplikantët jashtë Kosovës dhe për të verifikuar pajtueshmërinë e tyre me anë të thirrjeve telefonike drejt aplikantëve. Ky proces ngre shqetësime në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale të aplikantëve.

¹¹¹ Në qendrat e votimit, secili anëtar i KVV-së numëron votat preferenciale të hedhura për kandidatët e partisë së tij/saj nominuese, e cila nuk siguron përgjegjësinë dhe integritetin e procesit.

¹¹² Neni 216 i kodit penal nuk kërkon as dashjen e provuar për falsifikim të rezultateve.

¹¹³ Shih nenin 102 të LZP dhe nenin 25.1 të Rregullores së KQZ 9/2013.

vendvotimit të atij vendi. Përkundër një afati 24 orësh për paraqitjen e ankesave të tilla, PZAP e konsideron të papranueshëm dhe "të parakohshëm" çdo kundërshtim të rezultateve në vendvotimeve derisa të përfundojë procesi në QNR. Përderisa PZAP shpjegon se procesi në QNR mund të trajtojë shqetësimet e ankuesve, kjo praktikë nuk është e përshkruar me ligj. Ligji përmban disa dispozita të paqarta dhe kontradiktore për rinumërimet dhe anulimin e rezultateve;¹¹⁴ kjo nuk ofron mbrojtje nga vendimet e paqëndrueshme ose arbitrare nga KQZ dhe PZAP.¹¹⁵ Në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare, në rast të anulimit të rezultateve në një ose më shumë vendvotime, një votim i përsëritur duhet të mbahet. Përkundër kësaj kërkesë ligjore, KQZ-ja nuk urdhëroi përsëritjen e votimit, duke e hequr kështu drejtën e votimit nga votuesit e kualifikuar.¹¹⁶

XV. VOTIMI, NUMËRIMI DHE TABELIMI I REZULTATEVE

Votim ka qenë i rregullt dhe i mirë-organizuar; megjithatë, procesi i numërimit rezultoi në një numër të madh të rezultateve të pasakta në vendvotime

Votimi dhe Numërimi

Në përputhje me praktikën standarde për MEZ BE, asnjë vëzhgues nuk ishte vendosur për të vëzhguar procedurat e ditës së zgjedhjeve në një mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse, por anëtarët e MEZ BE vizituan një numër të kufizuar të vendvotimeve në Prishtinë. Zyra e BE-së vendosi rreth 30 ekipe të "Diplomatic Watch" (vrojuesve diplomatik) pjesëmarrës në 188 qendra votimi në të gjitha 38 Komunat.¹¹⁷ Subjektet politike vendosën rreth 26,600 vëzhgues, përderisa organizatat vëzhguese qytetare rreth 2,600, dukshëm më pak se në 2019 për këto të fundit.¹¹⁸

¹¹⁴ Neni 26.1 i Rregullës së KQZ-së 9/2013 parashikon anulimin në rast se ka ndonjë ndikim në rezultatet përfundimtare, në përputhje me nenin 21.123.b, 28 120.1 (b) të LZP-së dhe rinumërimin në rast të mospërputhjeve të numrit të fletëvotimeve të hedhura dhe nënshkrimeve në LV-në kundrejt nenit 5.1 niveli i tolerancës

¹¹⁵ Shih nenin 106.2 të LZP-së. Paragrafi II.3.3.e i Kodit të Praktikave të Mira i Komisionit të Venecias deklaron se "[ai] organ i apelit duhet të ketë kompetencë të anulojë zgjedhjet kur parregullsitë mund të kenë ndikuar në rezultat. Duhet të jetë e mundur të anulohen zgjedhjet në tërësi ose vetëm rezultatet për një zonë zgjedhore ose një qendër votimi." Në Riza dhe të tjerët k. Bullgarisë (aplikacionet nr. 48555/10 dhe 48377/10; 13/01/2016), GJEDNJ përsëriti se "procesi i vendimmarrjes mbi papranueshmërinë ose kontestimin e rezultateve të zgjedhjeve shoqërohet me kritere të hartuara për të parandaluar vendimet arbitrare. Në veçanti, një zbulim i tillë duhet të arrihet nga një organ i cili mund të sigurojë një minimum garancish për paanësinë e tij. Në mënyrë të ngjashme, diskrecioni që gëzon organi në fjalë nuk duhet të jetë tepër i gjerë; duhet të përcaktohet, me saktësi të mjaftueshme, përmes dispozitave të ligjit vendor."

¹¹⁶ Shih paragrafin 101 të Kodit të Komisionit të Venecias i Praktikës së Mirë: "Kompetencat e organeve apeluese janë gjithashtu të rëndësishme. Ato duhet të kenë kompetencë të anulojnë zgjedhjet nëqoftëse çrregullimet kanë ndikuar në rezultatet, p.sh. kanë ndikuar në shpërndarjen e mandateve. Ky është parimi kryesor, por ai duhet të jetë fleksibël për përshtatje, d.m.th. nuk është e nevojshme që anulimi të ndikojë në rezultatet e të gjithë vendit ose të zonës zgjedhore – pra, po të jetë e mundur, të anulohen rezultatet vetëm në një qendër votimi. Kjo bën të mundur që të shmangen dy ekstreme – anulimi i të gjitha zgjedhjeve, edhe pse çrregullimet kanë prekur vetëm një zonë, dhe refuzimi për anulim, sepse zona e prekur është shumë e vogël. Në zona ku rezultatet janë anuluar, zgjedhjet duhet të përsëriten.

¹¹⁷ Ekipet e "Diplowatch" ishin të përbëra nga Ambasadat e MS të BE-së, PSBE, ZBE dhe stafi i EULEX-it.

¹¹⁸ Në vitin 2019, subjektet politike kishin 29,339 vëzhgues, ku partitë kryesore politike kishin rreth 5,000 secili, përderisa kishte rreth 4,154 vëzhgues të shoqërisë civile.

Votimi u realizua në 2,382 vendvotime të vendosura në 888 qendra të votimit, të cilat u hapën në 07.00 dhe u mbyllën në 19.00. Procesi i votimit u administrua nga rreth 16,276 Anëtarë të Këshillave të Vendvotimeve (KVV-të).¹¹⁹ Përderisa KQZ nuk publikon ndonjë statistikë mbi përbërjen e komisioneve zgjedhore, vëzhguesit qytetarë vlerësojnë se rreth 31 përqind e anëtarëve të KVV ishin gra, 4 përqind më pak se në vitin 2019.

Sipas pjesëmarrësve të “Diplowatch” dhe vëzhguesve qytetarë, procesi i përgjithshëm gjatë ditës së zgjedhjeve ishte i rregullt dhe i qetë dhe në përgjithësi janë ndjekur procedurat. Reduktimi i numrit të votuesve të regjistruar dhe rrjedhimisht zvogëlimi i numrit të vendvotimeve shkaktoi disa vështirësi për votuesit në identifikimin e vendvotimit të tyre. Parregullsitë e zakonshme të raportuara nga vëzhguesit qytetarë gjatë procesit të votimit përfshinin votimin me dokumente të pavlefshme, siç janë letërnjoftimet e UNMIK-ut, letërnjoftimet e huaja ose dokumentet e skaduar të Kosovës. Për më tepër, një numër votuesish justifikuan paraqitjen e letërnjoftimeve të skaduar duke shpjeguar se nuk u ishin lëshuar të reja për shkak të kufizimeve të COVID-19. Si reagim ndaj kësaj, KQZ lejoi votuesit e tillë të votonin.

Janë shënuar raste të votimit familjar dhe në grup. Përveç kësaj, ngjashëm me vitin 2019, kishte një numër të madh të votimeve të asistuar.¹²⁰ U vërejtën disa mangësi të reja procedurale shtesë, gjegjësisht votuesit jo gjithmonë hiqnin përkohësisht maskat e tyre për t'u identifikuar nga KVV, në kundërshtim me udhëzimin administrativ të KQZ-së. Protokollet shëndetësore COVID-19 shpesh nuk respektoheshin plotësisht, përfshirë aty mbajtjen e maskave të fytyrës dhe dorezave, përdorimin e pastruesit të duarve dhe mbajtjen e një distancë prej dy metrash, veçanërisht gjatë pasdites kur vendvotimet ishin shpesh të mbushura me njerëz.

Për herë të parë, numri i KVV-ve u shtyp në fletëvotimet, gjë e cila është një masë sigurie kundër përdorimit të fletëvotimeve në vendet e tjera të votimit. Nga KVV ende është kërkuar ta vulosë çdo fletëvotim pas dorëzimit të votuesit, në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.¹²¹ Në bazë të raportimeve të mediave, në katër vendvotime numri i zarfeve për fletëvotimet me kusht nuk ishte i mjaftueshëm për të akomoduar pjesëmarrjen e lartë të votuesve të cilët nuk ishin regjistruar në qendrat specifike të votimit. KQZ-ja siguroi zarfe shtesë dhe orët e votimit në këto qendra votimi u zgjatën deri në orën 20:00, për t'iu mundësuar votuesve të votonin me fletëvotimet me kusht.¹²²

Raportohet se një numër i madh i votuesve shqiptarë të diasporës vizituan Kosovën për të votuar personalisht. Më 11 shkurt, qeveria lëshoi një vendim që thoshte se të gjithë qytetarët e Kosovës, përfshirë banorët jashtë Kosovës, u kërkohet të paraqisnin një test negativ PCR COVID-19 të bërë 72 orë para hyrjes në Kosovë ose të vetë-izoloheshin për shtatë ditë. Kërkesa për PCR u prezantua

¹¹⁹ Përveç 2,383 Kryesuesve, KVV-të ishin të përbërë edhe nga 11,828 anëtarë dhe 2,066 anëtarë rezervë.

¹²⁰ Me ligj, votuesit me aftësi të kufizuara dhe ata analfabetë mund të ndihmohen nga një person i zgjedhur prej tyre i cili nuk është anëtar ose vëzhgues i KVV-së dhe nuk ka ndihmuar votuesit e tjerë.

¹²¹ Shih paragrafin 34 të KV Kodit të Praktikës së Mirë: “Nënshkrimi dhe vulosja e fletëve të votimit nuk duhet bërë në momentin kur fleta i dorëzohet zgjedhësit, sepse nënshkrimi i personit pranë vulës mund të shërbejë si shenjë, e cila do të identifikonte zgjedhësin kur të bëhej numërimi i votave. Kjo do të ishte shkelje e fshehtësisë së votës.”

¹²² Përderisa numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar ishte 1,794,862, numri i fletëvotimeve të shtypura ishte 1,617,200.

në kohën kur masat e tjera anti-COVID-19 ishin të zbutura dhe derisa autobusët e votuesve jashtë Kosovës ishin tashmë rrugës për në Kosovë. Për këtë arsye, disa bashkëbisedues të MEZ BE pretenduan se ky vendim kishte për qëllim parandalimin e votuesve të diasporës për të hyrë në Kosovë dhe për të votuar personalisht.

Votuesit e jashtë Kosovës që banojnë në Serbi vizituan Kosovën për të votuar personalisht në ditën e zgjedhjeve në numër më të lartë se gjatë zgjedhjeve paraprake, pjesërisht sepse fletëvotimet postare nga Serbia nuk u pranuan në vitin 2019 pas një vendimi të gjykatës. Kjo shpjegon numrin shumë të ulët (rreth 160) të aplikacioneve nga Serbia për t'u regjistruar për votimin jashtë Kosovës. Siç edhe lejohet me ligj, ata hedhin votat me kusht në komunat me shumicë serbe të Kosovës, në vend të vendvotimeve ku janë regjistruar diku tjetër në Kosovë. Përafërsisht 30 autobusët të cilët arritën përmes kalimit administrativ në Jarinjë nuk u përballën me ndonjë pengesë.

KQZ-ja dha përditësime të rregullta mbi pjesëmarrjen e votuesve dhe rezultatet sipas komunave. Deri në orën 10:00 të datës 15 shkurt, KQZ-ja kishte përpunuar të dhënat nga 98 përqind të vendvotimeve. Numri i përgjithshëm i votuesve që votuan ditën e zgjedhjeve ishte rreth 845,000 (45.6 përqind) krahasuar me rreth 853,700 votues në 2019.¹²³ Pjesëmarrja e raportuar në katër komunat me shumicë serbe të Kosovës ishte 77.47 përqind, dukshëm më e lartë se mesatarja e gjithë Kosovës.¹²⁴ Kjo mund të shpjegohet me çregjistrimin e votuesve me letërnjoftime të UNMIK-ut dhe votimin e kushtëzuar personalisht të serbëve jashtë Kosovës.

Tabelimi i Rezultateve

Mandati i Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është tabelimi i votave të VV-ve të rregullta, verifikimi dhe numërimi i fletëvotimeve me kusht dhe jashtë Kosovës si dhe rinumërimi i VV-ve individuale.

Pas auditimit të brendshëm të gjithë 2,382 VV, KQZ-ja vendosi të rinumërojë fletëvotimet nga 564 VV-të. Dymbëdhjetë kuti votimi u rinumëruan pasi ishin në karantinë, pasi që mungonin disa materiale të ndjeshme, si formularët e rezultateve, libri i votimeve, vulat origjinale të VV, etj. Shumica dërmuese e 552 kutive të votimit të mbetura u rinumëruan, kryesisht për shkak të mospërputhjet në mes të numrit të votave preferenciale për kandidatë individualë dhe numrin e votave të hedhura për subjektin e tyre politik (511 VV). Afro 370 vendvotime u rinumëruan sepse kandidatët individualë morën më shumë vota preferenciale sesa numri i përgjithshëm i votave të marra nga subjekti i tyre politik. Dy rezultate të vendvotimeve u anuluan për faktin se kishte një mospërputhje prej më shumë se pesë votash në mes të numrit të votave të hedhura dhe numrit të nënshkrimeve në listën e votuesve të VV.¹²⁵ Rezultati i rinumërimit zbuloi disa

¹²³ Pas çregjistrimit të rreth 122,421 votuesve të regjistruar me letërnjoftimet e skaduara të UNMIK-ut, për këto zgjedhje, 1,794,862 votues u regjistruan, krahasuar me 1,961,216 në vitin 2019.

¹²⁴ Për këto zgjedhje, 32,716 votues votuan në katër komunat me shumicë serbe, për dallim nga 26,442 në 2019. Në vitin 2019, totali prej 3,782 fletëvotimesh me postare u dërguan nga Serbia.

¹²⁵ KQZ përcakttoi një prag të mospërputhjes maksimale nga tre vota në mes të numrit të fletëvotimeve të hedhura dhe numrit të nënshkrimeve të votuesve në listën e votuesve të VV. Vendvotimet e anuluar: një VV në komunën e Vushtrisë dhe një VV në komunën e Mitrovicës Veriore.

mospërputhje të mëdha në lidhje me numrin e votave preferenciale të numëruara për kandidatët e pavarur; megjithatë, mospërputhjet në numrin e votave për subjektet individuale politike ishin të vogla.

Rekomandimi: Të merret parasysh realizimi i tabelimit të rezultateve të qendrave të votimit në nivelin komunal. Niveli shtesë i procesit të tabelimit mund të rrisë transparencën dhe shpejtësinë e procesit të tabelimit. Tabelimi i rezultateve të vendvotimeve dhe pranimit të materialeve të ndjeshme nga Kryetari/anëtarët e këshillit të vendvotimit do të rrisin llogaridhënien e tyre pasi që çdo mospërputhje do të konstatohej në praninë e tyre.

Procesi i rinumërimit të fletëvotimeve dhe verifikimi dhe numërimi i fletëvotimeve me kusht dhe jashtë Kosovës zgjati 18 ditë, ngjashëm me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2017. I njëjti proces zgjati 53 ditë gjatë zgjedhjeve paraprake parlamentare, kryesisht për shkak të gabimeve teknike në shtypjen e formularit të rezultateve. Procesi është shumë i gjatë pjesërisht për shkak të faktit se të gjitha rinumërimet bëhen në një qendër kombëtare e jo në nivelin komunal. Gjithashtu, nevoja për të kontrolluar fletëvotimet me kusht dhe fletëvotimet jashtë Kosovës kundrejt listave të votuesve të VV për të shmangur votimin e mundshëm të shumëfishtë e zgjat procesin.

Fillimisht procesi i rinumërimit të VV u krye në QNR nga 28 ekipe. Pas disa ditësh rinumërimesh, numri i ekipeve u rrit në 40 për të shpejtuar procesin. Procesi i rinumërimit u vëzhgua nga një numër i madh i vëzhguesve partiakë dhe të shoqërisë civile. Vëzhguesit e partisë nga LVV ishin më të shumtë dhe aktivë sesa vëzhguesit nga partitë e tjera shqiptare të Kosovës.

KQZ-ja publikoi rregullisht format e rezultateve të reja të VV-ve të rinumëruara së bashku me format e rezultateve fillestare në ueb faqen e saj. Megjithatë, KQZ nuk publikoi ndonjë rezultat të ri të përkohshëm para shpalljes së rezultateve përfundimtare më 4 mars për të rritur transparencën e procesit të rezultateve. KQZ-ja nuk publikoi as edhe një analizë të procesit të rinumërimit për të identifikuar numrin e gabimeve teknike/numerike përballë përpjekjeve për të manipuluar rezultatet e zgjedhjeve nga këshillat e VV-ve.

Verifikimi dhe numërimi i fletëvotimeve me kusht

Procesi i verifikimit dhe numërimit të fletëvotimeve me kusht, duke përfshirë votat me nevoja të veçanta (VNV) përfundoi më 1 mars.¹²⁶ Prej rreth 34,000 fletëvotimeve të kushtëzuara të hedhura, 32,290 vota u verifikuan dhe u numëruan nga KQZ. Gjatë procesit të verifikimit, të gjithë emrat e votuesve që votuan me kusht u futën manualisht në sistemin e kompjuterizuar dhe u krahasuan me listën e skanuar të votuesve nga VV të rregullta për të identifikuar votimin e mundshëm të shumëfishtë. Rezultatet e numërimit të votave me kusht të hedhura në Kosovë në ditën e zgjedhjeve në masë të madhe ishin të ngjashme me ato të votimit të rregullt në VV.

¹²⁶ VNV janë hedhur nga votuesit në ditën e zgjedhjeve jashtë vendvotimeve (votuesit e lidhur me vendbanim, votues të shtruar në spital, etj.)

Verifikimi dhe numërimi i fletëvotimeve jashtë Kosovës

Verifikimi dhe numërimi i fletëvotimeve jashtë Kosovës u finalizua më 3 mars. Procesi i verifikimit ishte shoqëruar me gabime dhe u pa si kundërthënës nga përfaqësuesit e LVV, të cilët kritikuan personelin e KQZ/QNR që nuk kanë pasur një procedurë zyrtare të aprovuar për verifikimin e fletëvotimeve jashtë Kosovës dhe akuzuan stafin e QNR-së se nuk ishin të trajnuar si duhet për të kryer këtë aktivitet. Kishte gjithashtu një numër ankesash lidhur me transparencën e verifikimit të votave jashtë Kosovës dhe mungesën e mundësisë për vëzhguesit e partive për të vëzhguar verifikimin kompjuterik të zarfeve/fletëvotimeve jashtë Kosovës kur janë kryer nga nëpunësit individualisht. Stafi i QNR kreu një kontroll shtesë të procesit të verifikimit pasi të gjitha votat jashtë Kosovës ishin verifikuar dhe rreth 2,000 vota fillimisht të refuzuara u rivendosën.

Brenda afatit për pranimin e votave jashtë Kosovës të 12 shkurtit, KQZ-ja pranoi 43,477 artikuj/pako postare. Në këta artikuj postar kishte më shumë se 79,000 fletëvotime. Nga ato, numri më i madh i votuesve të refuzuar ishin ata që nuk kishin aplikuar për regjistrim brenda kohës së caktuar ose kërkesa për regjistrim e të cilëve ishte refuzuar gjatë procesit të regjistrimit. Bazuar në vendimin e KQZ-së, më shumë se 1,600 votues u refuzuan për dërgimin e votave të tyre në të njëjtën pako si ato me mbiemra të ndryshëm; Në përgjithësi, rreth 58,000 vota postare jashtë Kosovës u miratuan gjatë procesit të verifikimit dhe janë përfshirë në rezultatet, duke përfaqësuar 6.4 përqind e të gjitha votave të hedhura dhe rreth 57 përqind e të gjithë votuesve të regjistruar për votimin jashtë Kosovës.

KATEGORIA	ARSYETIMI I REFUZIMIT	NR. I FLETËVOTIMEVE ME POSTË
D1	Personat që nuk kanë aplikuar të regjistrohen si votues jashtë Kosovës	9,199
D2	Aplikantët të cilët u refuzuan gjatë periudhës së regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës	6,665
D4	Personat që dërguan fletëvotimet më shumë se një herë	1,325
D5	Votuesit e paidentifikuar (të cilët dërguan vetëm fletëvotimin pa letërnjoftim) ose personat që dërguan më shumë fletëvotime sesa numri i votuesve të aprovuar (p.sh. 5 votues të aprovuar, 7 fletëvotime)	2,451
D6	Personat që dërguan kopjet e letërnjoftimeve të skaduar	910
D7	Votimi në grup (fletëvotimet brenda së njëjtës paketë janë nga familje dhe mbiemra të ndryshëm; p.sh. 1 paketë ka brenda 84 fletëvotime të dërguara me postë)	1,656
D8	Pakot që ishin dërguar personalisht në postën nr. 6 në Prishtinë	385

XVI. REZULTATET DHE AMBIENTI PAS ZGJEDHJEVE

Rezultatet përfundimtare të pa-certifikuara u ndryshuan pas ankesave të suksesshme nga partitë jo-shumicë

KQZ publikoi rezultatet preliminare online (sistemi i KZQ-së për votimin brenda Kosovës) për subjektet politike të ndara sipas vendvotimeve (VV) brenda disa orësh pas përfundimit të numërimit të rregullt të votave në VV. Megjithatë, e metë e dukshme ishte fakti se nuk kishte rezultate progresive për mbarë Kosovën gjatë tabelimit dhe numërimit të fletëvotimeve me kusht dhe të atyre jashtë Kosovës.

Krahasimi i rezultateve preliminare të votave brenda Kosovës dhe i rezultateve përfundimtare të shpallura dhe rezultateve përfundimtare të certifikuara.

SUBJEKTI POLITIK**	REZULTATET PRELIMINARE TË VOTAVE BRENDA KOSOVËS		REZULTATET PËRFUNDIMTARE (të pa certifikuara)		REZULTATET PËRFUNDIMTARE (të certifikuara)	
	%	Ulëse*	%	Ulëse	%	Ulëse
LVV	47.85	56	49.952	58	50.28	58
PDK	17.41	20	16.9	19	17.009	19
LDK	13.08	15	12.647	15	12.731	15
AAK	7.43	9	7.078	8	7.124	8
Srpska Lista (Serbe)	5.54	10	5.06	10	5.094	10
KDTP (Turke)	0.78	2	0.74	2	0.745	2
UZ-AH (Boshnjake)**	0.81	1	0.732	1	-	-
VAKAT (Boshnjake)	0.72	1	0.678	1	0.616	1
IRDK (Egjiptiane)	0.35	1	0.377	1	0.379	1
RI (Rome)	0.48	2	0.461	2	0.364	1
NDS (Boshnjake)	0.35	1	0.33	1	0.331	1
SDU (Boshnjake)***	-	-	-	-	0.292	1
JGP (Gorane)	0.27	1	0.246	1	0.246	1
PAI (Egjiptiane)	0.23	1	0.244	1	0.244	1
LPRK (Rome)	-	-	-	-	0.139	1

* Llogaritja jozyrtare

** Tabela përfshin vetëm partitë që kanë fituar ulëse në Kuvend

*** Rezultatet dhe ulëset për këtë parti ndryshuan pas vendimeve të PZAP-it dhe të Gjykatës Supreme

Më 4 mars, që i bie 18 ditë pas ditës së zgjedhjeve, KQZ njoftoi dhe publikoi në faqen e internetit rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, të cilat ende mund t'i nënshtroheshin kundërshtimeve dhe, në fund të certifikoheshin. Rezultatet e publikuara përfshinin rezultatet për subjektet politike si dhe

rezultatet për kandidatët individualë brenda secilit subjekt politik të paraqitura sipas VV-ve. Sa i përket përqindjes së votave totale të vlefshme të fituara nga subjektet politike, kishte disa ndryshime midis rezultateve përfundimtare të shpallura dhe rezultateve preliminare të votave brenda Kosovës të cilat u publikuan menjëherë pas ditës së zgjedhjeve.¹²⁷ Pas numërimit të rreth 56.000 fletëvotimeve të votimit jashtë Kosovës, LVV siguroi dy vende të tjera në rezultatet përfundimtare në dëm të PDK-së dhe AAK-së pasi 78.5 përqind e votave nga diaspora ishin në mbështetje të LVV-së.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2021 u fituan nga LVV me 49.95 përqind të votave, duke siguruar 58 ulëse në Kuvendin e ardhshëm. Pasuan tri partitë e tjera shqiptare të Kosovës, ku PDK mori 16.9 përqind të votave, LDK 12.6 përqind të votave dhe AAK 7 përqind të votave.

Pranimi i rezultateve

Njëzet nga 120 ulëset në Kuvend janë të rezervuara për komunitetet jo-shumicë dhe janë të shpërndara në mënyrën në vijim: dhjetë ulëse për Serbët e Kosovës, tre për Boshnjakët e Kosovës, dy për Turqit e Kosovës dhe nga një për Goranët e Kosovës, Romët e Kosovës, Ashkëtinjtë e Kosovës dhe Egjiptianët e Kosovës, dhe një ulëse shtesë i jepet komunitetit me numrin më të madh të votave të siguruar nga njëra prej tri komuniteteve të fundit.


Para zgjedhjeve, disa akterë politik pretenduar se SL, forca politike dominuese brenda politikës serbe në Kosovë (praktikisht e pa sfiduar nga subjektet tjera politike serbe në Kosovë që garojnë në zgjedhjet e vitit 2021) po përpiquej të rriste tërthorazi 'peshën' e saj në Kuvend duke 'shpërndarë' në mënyrë strategjike një pjesë të mbështetjes së saj për iniciativat e reja në mesin e komuniteteve boshnjake dhe rome të Kosovës.¹²⁸ Rezultatet përfundimtare (të pa certifikuar) të zgjedhjeve të shpallura më 4 mars nxitën këto akuza: së pari, kishte një rritje të konsiderueshme të numrit të përgjithshëm të votave për të dy komunitetet krahasuar me zgjedhjet e mëparshme; së dyti, shumica dërrmuese e votave për dy subjektet e reja politike - UZ - AH e udhëhequr nga Adriana Hodžić (qytetare boshnjake e Kosovës) dhe Iniciativa Rome (IR) e udhëhequr nga Gazmend Salijević - erdhën nga komunat në Kosovë që kishin një popullsi të madhe serbe. Kishte gjithashtu një rritje të dukshme të votave për koalicionin VAKAT (komuniteti boshnjak i Kosovës). Në zgjedhjet e mëparshme votat për komunitete tjera jo-shumicë nga këto komuna ishin minimale.¹²⁹

¹²⁷ Rezultatet preliminare të votave brenda Kosovës nuk përfshijnë votat me kusht dhe votat jashtë Kosovës të dërguara me postë.


¹²⁸ Para zgjedhjeve, zonja Duda Balje nga Bashkimi Socialdemokrat (SDU) që përfaqëson komunitetin boshnjak të Kosovës pretendoi (më 27 janar) se LS po përpiquej të shpërndante një pjesë të votave të saj tek komunitetet, kandidatët ose listat tjera që janë në përputhje me interesat e LS. Ajo e përmendi partinë UZ - AH të udhëhequr nga Adriana Hodžić (Boshnjake) nga Mitrovica e Veriut (një nga katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës) dhe IR-në të udhëhequr nga Gazmend Salijević nga Graçanica (gjithashtu një komunë me shumicë serbe në Kosovë) si dy subjektet që përfitojnë nga kjo mbështetje. Këto dy iniciativa qytetare u shfaqën pasi zgjedhjet e vitit 2021 u thirrën në fillim të janarit. "Ata (LS) saktësisht llogaritën se mund të japin 3 deri në 4 mijë vota për atë alternativë boshnjake dhe një apo dy mijë vota për alternativën rome. Goranët kanë qenë me ta për ca kohë. Unë mendoj se qëllimi është të marrin 2/3 e votave të pakicave dhe kjo është një forcë e madhe brenda Kuvendit", ka thënë Balje.

¹²⁹ LS mori në total 44,404 vota (5.06 përqind). Ky rezultat ishte i mjaftueshëm që LS të sigurojë të gjitha 10 ulëset e rezervuara për serbët e Kosovës (LS fitoi 10 ulëse gjithashtu në zgjedhjet në 2019). Në të njëjtën kohë, numri i përgjithshëm i votave për LS u zvogëlua ndjeshëm krahasuar me një total prej 57,015 votave (6.4 përqind) të fituara në zgjedhjet në 2019 dhe 44,499 votave (6.11 përqind) të fituara në zgjedhjet në 2017.

VOTAT PËR KOMUNITETIN BOSHNJAK NË KOSOVË



VOTAT PËR KOMUNITETIN ROM NË KOSOVË



Të tri vendet e rezervuara për entitetet e Boshnjakëve të Kosovës u fituan (bazuar në rezultatet e pa certifikuar të 4 marsit) nga UZ-AH, Nova Demokratska Stranka (NDS) dhe koalicioni VAKAT. Adrijana Hodžić (UZ-AH), nënkryetare e komunës së Mitrovicës Veriore, argumentoi se sukcesi i saj në zgjedhje ishte rezultat i punës së saj afatgjate për komunitetet jo-shumicë në Kosovë. Megjithatë, ajo gjithashtu informoi MEZ të BE-së në lidhje me një marrëveshje joformale me përfaqësuesit e SL duke përfshirë një qasje reciproke jo-konfrontuese gjatë fushatës dhe të mosndërhyrjen në fushatat e tyre.

Sa i përket katër ulëseve të rezervuara për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, rezultatet e zgjedhjeve (të pa certifikuara) të shpallura nga KQZ më 4 mars ishin si më poshtë: Partia e Ashkalinjëve për Integrim (komuniteti Ashkali i Kosovës) dhe Iniciativa e Re Demokratike (komuniteti Egjiptian i Kosovës) e fituan nga një ulëse. Dy ulëse u fituan nga IR që përfaqëson komunitetin rom të Kosovës, pasi ajo gjithashtu mori vendin shtesë të caktuar për subjektin që mori numrin më të madh të votave nga tri komunitetet. Z. Artan Asllani, anëtar i KQZ-së (përfaqësues i komunitetit ashkali të Kosovës) informoi MEZ të BE-së se ky rezultat do të kishte një ndikim të konsiderueshëm në këto komunitete pasi komuniteti ashkali i Kosovës, më i madhi nga të tri komunitetet (sipas regjistrimit të popullsisë së të vitit 2011 ka rreth 15,500 pjesëtar) në katër zgjedhjet e kaluara parlamentare pa ndërprerje ka fituar ulësen shtesë e cila bazuar në rezultatet e 4 marsit u fitua nga IR që përfaqëson komunitetin më të vogël nga këto tri komunitete (që ka një popullsi prej rreth 9,000 pjesëtarëve).

Rinumërimet e urdhëruara nga PZAP pas shpalljes së rezultateve përfundimtare (të pa certifikuara)

Pas shpalljes së rezultateve më 4 mars nga KQZ-ja, u parashtruan gjithsej 210 ankesa në PZAP ndaj protokolleve të rezultateve. Këto ankesa u parashtruan kryesisht nga kandidatët, duke pretenduar parregullsi në numërimin dhe regjistrimin e votave preferenciale në protokollin e rezultateve. Disa ankesa u parashtruan gjithashtu nga subjekte politike duke pretenduar parregullsi në numërimin dhe regjistrimin e rezultateve për subjektet. Ankuesit kërkuan të bëhet rinumërimi në një numër të vendvotimeve të ndryshme.

Më 8 mars, PZAP pranoi 30 kërkesa dhe urdhëroi rinumërimin e pjesshëm të 134 vendvotimeve. Rreth 180 kërkesa u refuzuan me arsyetimin se nuk kishte prova të qarta dhe bindëse. Shumica e ankesave të pranuar nga PZAP kërkuan rinumërim për një vendvotim ose një numër të kufizuar të vendvotimeve ndërsa ankesat që kërkonin rinumërim në shumë vendvotime kryesisht u refuzuan. Vendimet e PZAP-it nuk ishin gjithmonë në përputhje. Për shembull, deklaratat e vëzhguesve të pranishëm në qendrat e votimit në fjalë nuk pranoheshin gjithmonë si prova të mjaftueshme.

Kandidatja e AAK-së (F. Gjergjaj) kërkoi rinumërimin e të gjitha fletëvotimeve me kusht dhe të votave jashtë Kosovës, duke pretenduar se kishte ndërhyrje në numërimin dhe regjistrimin e rezultateve në protokolle në dëm të saj dhe se kishte përfituar kandidatja e AAK-së dhe ish Ministria e Punëve të Jashtme Meliza Haradinaj. Ankesa u pranua nga PZAP e cila urdhëroi rinumërimin sipas kërkesës.

Përveç kësaj, LVV parashtrroi një ankesë duke kërkuar verifikimin dhe numërimin e rreth 9,748 (vetëm një sasi e vogël e këtyre pakove arriti më 13 shkurt) pakove që përmbajnë një numër të panjohur të fletëvotimeve të votimit jashtë Kosovës, të cilat mbërritën në Kosovë më 13 shkurt, përkatësisht një ditë pas afatit të caktuar nga KQZ.¹³⁰ Ankuesit përmendën afatet e shkurtra kohore dhe pengesat e tjera për zbatimin efektiv të votimit jashtë Kosovës. Ankesa u refuzua në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese duke njohur 12 shkurtin si afatin ligjor për

¹³⁰ Këto fletëvotime u dërguan me DHL nga Gjermania dhe nuk mbërritën në Kosovë më 12 shkurt për shkak të problemeve logjistike në aeroportin në Gjermani.

pranimin e ankesave që vijnë jashtë Kosovës. Në një ankesë të veçantë, LVV gjithashtu kërkoj numërimin e 20,550 fletëvotimeve të ardhura nga votimi jashtë Kosovës të cilat u morën brenda afatit të caktuar por nuk e kaluan kontrollin e verifikimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Ankesës iu refuzua pranueshmëria me arsyetimin se duhej të ishte parashtruar brenda 24 orëve nga shkelja e pretenduar.¹³¹

Më 3 mars, tri subjektet politike Nasa Iniciativa (NI), Socijal-demokratska Unija (SDU) dhe Nova Demokratska Stranka (NDS) kërkuar që të anulohen votat për dy subjekte politike që përfaqësojnë komunitetin boshnjak (UZ - Hodzic, VAKAT).¹³² PZAP pjesërisht pranoi ankesat dhe anuloi të gjitha votat për të pesë entitetet politike boshnjake të Kosovës (përfshirë votat e ankuesve) në shtatë komuna dhe disa nga votat e tyre në tre komuna shtesë.¹³³ PZAP vuri në dukje se numri i votave të fituara nga këto parti në këto vendvotime tejkalon numrin e banorëve boshnjakë.¹³⁴ Duket se vendimi i PZAP-it bazohet në një supozim se jo të gjitha votat për subjektet politike boshnjake dhe rome të Kosovës u dhanë përkatësisht nga votuesit boshnjakë dhe romë. PZAP vuri në dukje se votuesit e një komuniteti, në këtë rast të komunitetit serb, nuk mund të sigurojnë përfaqësimin e një komuniteti tjetër, përkatësisht të komunitetit boshnjak. PZAP shpjegoi se kjo bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin që sigurojnë ulëse të garantuara për përfaqësimin e secilit komunitet jo-shumicë.¹³⁵ Megjithatë, ligji nuk kërkon në mënyrë shprehimore që një subjekt politik që përfaqëson një komunitet jo-shumicë të marrë vota vetëm nga pjesëtarët e komunitetit përkatës jo-shumicë dhe nuk ka baza të tilla ligjore për anulimin e votave. Në të kundërt, me ligj, votuesit që i përkasin një komuniteti jo-shumicë mund të votojnë për çdo subjekt politik dhe jo vetëm për ata që përfaqësojnë komunitetin e tyre. SDU apeloj vendimin e PZAP-it, i cili u vërtetua nga Gjykata Supreme. Gjykata Supreme vuri në dukje se gjykatat duhet të zbatojnë drejtpërdrejt Kushtetutën kur është e nevojshme.¹³⁶

Ngjashëm, një numër i subjekteve politike rome, ashkali dhe egjiptiane (RAE) kërkuar anulimin e votave të fituara nga Iniciativa Rome (IR).¹³⁷ Kërkesa u pranua pjesërisht dhe votat për IR u anuluan në një numër vendvotimesh në pesë komuna.¹³⁸ Arsyetimi i vendimit të PZAP-it është i njëjtë me atë të vendimit për subjektet politike boshnjake.

¹³¹ Neni 105.1 i LZP parasheh se ankesat në lidhje me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i të kuptuarit për shkeljen e supozuar.

¹³² Gjatë procesit të numërimit dhe tabelimit në QNR, SDU - Duda Balje kishte parashtruar dy ankesa të ngjashme duke kërkuar anulimin e votave për Hodzic dhe Koalicionin Vakati. PZAP kishte refuzuar pranueshmërinë e këtyre ankesave si "të parakohshme", pasi procesi në QNR ishte ende në pritje.

¹³³ Përkatësisht në Zubin Potok, Shtërpçë, Ranillug, Graçanicë, Partesh, Klllokot dhe Novobërdë, Zveçan, Leposaviq dhe Mitrovicë.

¹³⁴ Vendimi i PZAP-it u bazua në një raport të OSBE-së të vitit 2018 që përmbante numrin e popullsisë boshnjake në secilën komunë.

¹³⁵ Përkatësisht neni 58.4 i Kushtetutës dhe neni 111.1 i LZP.

¹³⁶ Bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KI207/19.

¹³⁷ Përkatësisht Partia Liberale (PLE), Partia e Ashkalinjëve për Integritet (PAI), Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) dhe Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK) dhe Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK).

¹³⁸ Përkatësisht në Ranillug, Partesh, Klllokot dhe Novobërdë, Leposaviq dhe Mitrovicë.

XVII. REKOMANDIMET

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në Raportin Përfundimtar ‘RP’)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE*	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI – ZOTIMI - LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
KORNIZA LIGJORE					
1	LZP skualifikon për tri vjet ata që janë dënuar për çfarëdo vepr penale pas vendimit të formës së prerë të gjykatës. Derisa përjashtimi i shkelësve të ligjit nga parlamenti i shërben një qëllimi legjitim, skualifikimi pavarësisht nga serioziteti i krimit është jo proporcional dhe në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. Për më tepër, LZP nuk është në përputhje me Kushtetutën e cila kërkon një vendim të gjykatës që privon shprehimisht të drejtat e votës dhe me Kodin Penal që skualifikon vetëm ata që dënohen për vepra që lidhen me zgjedhjet ose vepra të dënueshme me burgim për më shumë se dy vjet.	Të përcaktohet papërshtatshmëria e kandidatit vetëm për një dënim penal të formës së prerë për veprat e rënda penale dhe në përputhje me një vendim të gjykatës i cili shprehimisht privon individin e dënuar nga e drejta e kandidimit. Të harmonizohen dispozitat e zbatueshme në ligjin zgjedhor dhe kodin penal.	Neni 29 i LZP	Kuvendi	Neni 3 i Protokollit Nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut – E drejta për zgjedhje të lira “Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.” ICCPR, neni 25 “Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme: (b) Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të mirëfillta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve”. ICCPR, neni 25, HRC GC 25 “1. Neni 25 i Paktit njuh dhe mbron të drejtën e çdo qytetari për të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur dhe të drejtën për të pasur qasje në shërbimin publik. Çfarëdo qoftë forma e kushtetutës apo qeverisë që është në fuqi, Pakti kërkon që Shtetet të miratojnë masa të tilla legjislative dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për të siguruar që qytetarët të kenë një mundësi efektive për të gëzuar të drejtat që mbrohen me Pakt.” Pjesa I.1.1.d e Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore e Komisionit të Venecias thekson se: “i. Mund të miratohen dispozita për privimin e individëve nga e

* Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me RKSKB 1244/1999 dhe mendimin e GJND për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në Raportin Përfundimtar ‘RP’)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE*	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI – ZOTIMI - LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
					drejta e tyre për të votuar apo për t'u zgjedhur, por vetëm në rast se ekzistojnë të gjitha kushtet e mëposhtme: ii. Duhet të parashikohet nga ligji; iii. Duhet të respektohet parimi i proporcionalitetit; kushtet për privimin e individëve nga e drejta për t'u zgjedhur mund të jenë më pak strikte se sa kushtet për privimin e tyre nga e drejta për të votuar; iv. privimi mund të aplikohet në rastin e paaftesisë mendore ose të dënimit nga gjykata për një vepër të rëndë penale; v. Përveç kësaj, abrogimi i të drejtave politike ose përcaktimi i paaftesisë mendore mund të aplikohet vetëm me vendim të posaçëm të gjykatës.” Shih gjithashtu paragrafët 137-139, 150-151 e Raportit të Komisionit të Venecias për Përfashtimin e Shkelësve të Ligjit nga Parlamenti .
ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE					
2	Pas auditimit të brendshëm të të gjitha 2,382 vendvotimeve, KQZ vendosi të rinumërojë fletët e votimit nga 564 vendvotime. Dymbëdhjetë kuti të votimit u rinumëruan pasi ishin në karantinë pasi disa materiale të ndjeshme mungonin, të tilla si formularët e rezultateve, libri i votimit, vulat origjinale të vendvotimit, etj. Shumica dërmuese e 552 kutive të votimit të mbetura u rinumëruan kryesisht për shkak të mospërputhjes midis numrit të votave preferenciale për	Të merret parasysh realizimi i tabelimit të rezultateve të qendrave të votimit në nivelin komunal. Niveli shtesë i procesit të tabelimit mund të rrisë transparencën dhe shpejtësinë e procesit të tabelimit. Tabelimi i rezultateve të vendvotimeve dhe pranimi i materialeve të ndjeshme nga Kryetari / anëtarët e këshillit të vendvotimit do të rrisin	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP)	Kuvendi	Zgjedhje të mirëfillta që pasqyrojnë shprehjen e lirë të vullnetit të votuesve ICCPR, GC 25, paragrafi 20: “Duhet të themelohet një autoritet i pavarur zgjedhor për të mbikëqyrur procesin zgjedhor dhe për të siguruar që ai të zhvillohet në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe në pajtim me ligjet që janë në pajtueshmëri me Paktin (...) “Siguria e kutive të votimit duhet të garantohet dhe votat duhet të numërohen në prani të kandidatëve ose të përfaqësuesve të tyre. Duhet të ketë një kontroll të pavarur të procesit të votimit dhe të numërimit dhe qasje në shqyrtimin gjyqësor ose në një proces tjetër ekuivalent, në mënyrë që zgjedhësit të kenë besim në sigurinë e votimit dhe numërimit të votave.”

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në Raportin Përfundimtar ‘RP’)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE*	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI – ZOTIMI - LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
	kandidatët individualë dhe numrit të votave për subjektin e tyre politik (511 vendvotime). Procesi i rinumërimit të fletëve të votimit zgjati 18 ditë, ngjashëm me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2017. Procesi është shumë i gjatë pjesërisht për faktin se të gjitha rinumërimet bëhen në një qendër kombëtare e jo në nivelin komunal menjëherë pas ditës së zgjedhjeve.	llogaridhënien e tyre pasi që çdo mospërputhje do të konstatohej në praninë e tyre.			
KONTESTET ZGJEDHORE					
3	Ligji përcakton një listë të kufizuar të vendimeve të KQZ-së që mund të apelohej në PZAP, duke përjashtuar vendimet e tjera në aspekte shumë të rëndësishme të procesit zgjedhor siç janë përbërja e komisioneve zgjedhore dhe regjistrimi i votuesve jashtë Kosovës. Vendimet e PZAP-it i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor vetëm nëse shqiptojnë gjoba që tejkalojnë një shumë të caktuar.	Të përcaktohet që të gjitha vendimet e KQZ-së të mund të kundërshtohen në PZAP dhe të mundësohet shqyrtimi gjyqësor, pavarësisht nga shuma e gjobës ose nëse preket një e drejtë themelore.	LZP	Kuvendi	E drejta për mjete juridike efektive, Sundimi i Ligjit ICCPR, GC 25, para. 20: “Duhet të themelohet një autoritet i pavarur zgjedhor për të mbikëqyrur procesin zgjedhor dhe për të siguruar që ai të zhvillohet në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe në pajtim me ligjet që janë në pajtueshmëri me Paktin (...)” ICCPR, neni 2.3 “(a) Të sigurojë që çdo person, kur t’i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Pakt, të ketë të drejtën e një mjeti juridik efektiv, edhe atëherë kur shkeljen e kryejnë personat me rastin e ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare; (b) Të sigurojë që autoriteti kompetent gjyqësor, administrativ ose legjislativ, ose çdo autoritet tjetër që është kompetent në bazë të legjislacionit të shtetit, do t’i përcaktojë të drejtat e këtij personi që paraqet mjetin juridik si dhe të zhvillojë mundësitë e paraqitjes së mjetit juridik; (c) Të sigurojë që autoritetet


NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në Raportin Përfundimtar ‘RP’)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE*	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI – ZOTIMI - LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
					kompetente do të veprojnë sipas çdo mjeti juridik që do të njihet si i përligjur.” Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR), neni 8 “Secili ka të drejtë që me mjete juridike efektive para gjykatave kompetente kombëtare të mbrohet nga veprimet e shkeljes së të drejtave themelore të garantuara me kushtetutë ose me ligj”. ICCPR, CG 25, para. 20: “Siguria e kutive të votimit duhet të garantohet dhe votat duhet të numërohen në prani të kandidatëve ose të përfaqësuesve të tyre. Duhet të ketë një kontroll të pavarur të procesit të votimit dhe të numërimit dhe qasje në shqyrtimin gjyqësor ose procesin tjetër ekuivalent, në mënyrë që zgjedhësit të kenë besim në sigurinë e votimit dhe numërimit të votave.”
MEDIAT (MEDIAT SOCIALE/TË DREJTAT DIGJITALE)					
4	Në disa faza të procesit, të dhënat personale dhe privatësia e qytetarëve nuk ishin të mbrojtura sa duhet. Rastet e përmendura nga misioni përfshinin publikimin e listave e votuesve (përfshirë votuesit jashtë Kosovës) nga KQZ-ja me detajet personale (emri, mbiemri, data e lindjes), dhe raste të SMS-ve të padëshiruara që nxisnin qytetarët të votojnë për një parti politike dhe këta SMS iu dërguan votuesve në ditën e zgjedhjeve pa pëlqim	Të harmonizohen legjislacioni zgjedhor dhe rregulloret e KQZ-së me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP) për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve për privatësinë e të dhënave të tyre personale që përdoren në procesin zgjedhor.	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Rregulloret e KQZ-së	Kuvendi i Kosovë dhe KQZ-ja	E drejta për privatësi ICCPR, neni 17: “Askush nuk duhet të jetë objekt i ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private... Secili ka të drejtë të ketë mbrojtje ligjore kundër ndërhyrjeve dhe shkeljeve të tilla.”

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në Raportin Përfundimtar ‘RP’)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE*	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI – ZOTIMI - LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
	paraprak dhe në shkelje të heshtjes zgjedhore. LZP dhe rregullorja e KZQ-së nuk janë në përputhje me LMDhP.				
5	Meqenëse legjislacioni zgjedhor mbetet kryesisht i pandryshuar për më shumë se një dekadë, ai nuk adreson çështje që lidhen me zhvillimet përkatëse siç janë rritja e rëndësisë së komunikimit digjital në fushatën zgjedhore ose nevoja për mbrojtje më të fuqishme e të dhënave personale dhe privatësisë së qytetarëve. Facebook ende nuk ka implementuar për Kosovën mjetet që lehtësojnë transparencën dhe llogaridhënien për reklamën politike; ishte e mundur të shihej vetëm sasia e reklamave e akterëve kryesorë politikë (faqet e të cilëve u ndoqën në Facebook) por jo shuma e fondeve të shpenzuara.	Të rishikohet legjislacioni zgjedhor në mënyrë që të pasqyrojë rëndësinë e rritur të aspekteve të komunikimit digjital në fushatën zgjedhore dhe në procesin zgjedhor në përgjithësi. Transparenca dhe përgjegjësia e fushatave online mund të promovohet duke krijuar arkiva të detyrueshme të reklamave në internet, duke përcaktuar kërkesa të hollësishme të raportimit për ata që paguajnë për materiale të sponsorizuara dhe për ata që morën pagesa.	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Rregulloret e KZQ-së	Kuvendi i Kosovë dhe KZQ-ja	Transparenca dhe qasja në informacion / Paanësia në fushatën zgjedhore Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UN CAC), neni 7.4: “Secili shtet palë, në përputhje me principet themelore të ligjit të vet të brendshëm, përpiqet të miratojë, ruajë dhe forcojë sistemet që nxisin transparencën dhe të parandalojnë konfliktet e interesave.” UN CAC, neni 7.3: “Secili shtet palë mendon gjithashtu të marrë masa të përshtatshme legjislative dhe administrative, ... për të rritur transparencën në financimin e kandidaturave për postin e zgjedhur politik dhe, kur është e zbatueshme, financimin e partive politike.” UN CAC, neni 13(b) “Secili shtet palë duhet... të garantojë që publiku ka të drejtën efektive për informacion.” E drejta për informacion ICCPR, HRC GC 25, para. 19: “Votuesit duhet të jenë në gjendje të formojnë opinionet në mënyrë të pavarur, pa dhunë ose kërcënim me dhunë, detyrimi, nxitje ose ndërhyrja manipuluese të çfarëdo lloji.”

XVIII. SHTOJCAT


Fushatat Online

NUMRI I DEBATEVE/INTERVISTAVE TË TRANSMETUARA ONLINE
NGA MEDIAT TRANSMETUESE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE




*Burimi: Socialbakers

NUMRI I POSTIMEVE NGA PARTITË NË FAQET
E TYRE NË FACEBOOK NË PERIUDHËN E FUSHATËS




*Burimi: Fanpage Karma

NUMRI MESATAR I POSTIMEVE NË DITË NË FAQET
E PARTIVE NË FACEBOOK GJATË PERIUDHËS SË FUSHATËS




*Burimi: Fanpage Karma


* Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me RKSKB 1244/1999 dhe mendimin e GjND për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

NUMRI I POSTIMEVE NË FAQET FACEBOOK
TË KANDIDATËVE/UDHËHEQËSVE TË PARTIVE
NË PERIUDHËN E FUSHATËS


*Burimi: Fanpagekarma

NUMRI MESATAR I POSTIMEVE NË DITË NË
FAQET FACEBOOK TË KANDIDATËVE /
UDHËHEQËSVE TË PARTIVE NË PERIUDHËN E FUSHATËS


*Burimi: Fanpagekarma

50 POSTIMET KRYESORE NË FACEBOOK
ME MË SË SHUMTI NDËRVEPRIME

* 27 të parat kanë qenë ekskluzivisht nga Albin Kurti dhe Vjosa Osmani nga LVV



*Burimi: Facebook Ad Library



*Burimi: Facebook Ad Library

